



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
GJIROKASTËR

RAPORT VJETOR
MBI ECURINË E PUNËS PËR VITIN 2022

DREJTUAR:
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Z. Olsian ÇELA
T I R A N Ë

Në mbështetje të neneve 148 dhe 148/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 dhe 50 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në urdhërat e udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, po ju paraqesim raportin vjetor lidhur me veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2022.

Veprimtaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë përfshin të gjitha fazat nëpër të cilat kalojnë çështjet penale, duke filluar nga faza e hetimeve paraprake, gjykimi dhe ekzekutimi i vendimeve penale. Në vëllimin e veprimtarisë përfshihen marrja dijeni për veprën penale, cilësimi ligjor i fakteve, drejtimi e kontrolli i hetimeve, drejtimi i kërkesave gjyqtarit të hetimeve paraprake, kërkesat drejtuar gjykatës për zgjidhjen e çështjeve, përfaqësimin e akuzës në gjykim, si dhe kryerja e veprimeve në ekzekutimin e vendimeve penale dhe përfaqësimi në gjykim i kërkesave penale që kanë lidhje me ekzekutimet e vendimeve penale.

Në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, një vëllim të konsiderueshëm zë edhe kryerja e veprimeve në sferën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë si dhe veprimtaria që lidhet me kërkesat për verifikimin e personalitetit e integritetit të shtetasve shqiptarë, të cilët ushtrojnë detyra publike në institucione shtetërore.

Bashkëpunimi ndërinstitucional përbën një orientim permanent në kryerjen e veprimtarisë së prokurorisë, i diktuar nga kuadri ligjor dhe kompetencat e institucioneve të tjera. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se bashkëpunimi me institucionet tona qëndrore, si Prokurori I Përgjithshëm e Këshilli I Lartë I Prokurorisë, konsiston në drejtim të zhvillimit të veprimtarisë normale të punës, për koordinimin e bashkërendimin e veprimtarisë, në ushtrimin e kompetencave proceduriale dhe administrative, në respektimin e parimeve të ligjshëmrisë, përgjegjshërisë dhe parimit të kontrollit të brendshëm, në respektimin e së drejtës së informimit, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Po kështu, një nga drejtimit e bashkëpunimit, është edhe ai me shërbimet e policisë gjyqësore, kryesisht me shërbimet e policisë së shtetit. Ky bashkëpunim konsiston në

respektimin e parimeve të ligjshmërisë, hirearkisë, pavarësisë, paanësisë si dhe parimin e përgjegjshmërisë. Roli i Drejtuesit të Prokurorisë në drejtim të kontrollit të veprimtarisë së policisë gjyqësore, përfshin diskutimin e problematikave me drejtues të shërbimeve, evidentimin e shqetësimeve konkrete dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre.

Të gjitha këto drejtime, duhet të bëhen të mundura vetëm nëse në bazë të veprimtarisë së prokurorisë vendosen zbatimi i përcaktimeve kushtetuese e ligjore, konkretizimi i tyre në urdhëra e udhëzime kur është e nevojshme, strukturimi dhe ndarja e veprimtarisë atë mënyrë që të respektohet jo vetëm parimi i ligjshmërisë, por edhe i llogaridhënies si dhe gjurmimi me sukses i informacionit dhe i përpunimit të të dhënave. Për të arritur një shkallë të lartë të efikasitetit dhe mbrojtjes së ligjshmërisë, funksionimi i brendshëm sipas përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore dhe rregullores së institucionit është një kërkesë e panegociueshme. Në këtë aspekt, ligjvënësi, duke marrë për bazë të gjitha pritshmëritë, ka ndarë kompetencat edhe brenda prokurorisë, duke caktuar detyra konkrete për drejtuesit, mbledhjen e prokurorëve, administratën dhe shërbimet mbështetëse. Nga ana tjetër, veprimtaria administrative është mjet për të arritur zhvillimin normal të veprimtarisë procedurale, e cila zhvillohet në bazë të rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin Penal, të interpretuara sipas kuadrut kushtetues.

Pasi bëmë një hyrje të të gjitha drejtimeve të veprimtarisë së prokurorisë, më poshte do të shtjellojmë një e nga një të gjitha këto drejtime, duke përshkruar me hollësi treguesit analitikë, krahasimorë, arritjet e problematikave të vërejtura në secilin prej tyre. Gjithashtu, do të japim edhe objektivat konkrete që prokuroria ka në terma afatshkurtër për vitin 2023 dhe afatmesëm e afatgjatë.

A) Disa të dhëna për Rrethin Gjyqësor Gjirokastër

Rrethi Gjyqësor ku Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër ushtron veprimtarinë, përfshin rrethet administrative të Gjirokastrës e Tepelenës, me një sipërfaqe prej 1954 km². Relievi i territorit në këtë rreth gjyqësor është kryesisht malor, por ka edhe terren fushor e kodrinor, kryesisht në luginat e lumenjve Vjosë e Drino. Në skajin jug- lindor, ky rreth gjyqësor kufizohet me shtetin grek. Duke qenë rreth kufitar, ka dy pika të kalimit kufitar të ngritura me marrëveshje ndërmjet dy shteteve, Pika Kufitare e Kalimit Kakavijë dhe Pika e Kalimit Kufitar Sopik.

Ky rreth gjyqësor karakterizohet nga një shkallë urbanizimi mesatar, pasi ka zona të thella ku nuk ka rrugë automobilistike të asfaltuara, ku mund të qarkullohet me vështirësi. Ky faktor ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik e shoqëror të komuniteteve që banojnë në ato zona.

Lëvizjet demografike në Qarkun e Gjirokastrës, kanë qenë të shumta kryesisht në drejtim të emigrimit në shtete të tjera dhe gjithashtu edhe migrimit nga këto zona drejt kryeqytetit dhe më pak drejt qyteteve të tjera. Po kështu, lëvizje janë shoqëruar nga komunitetet lokale rurale, drejt qendrave urbane në këtë rreth gjyqësor, kryesisht në qytetin e Gjirokastrës e më pak në qytetet e tjera.

Tipar i popullsisë janë elementë etnografike të përbashkëta, por edhe specifika dalluese sipas zonave. Në këtë rreth ka edhe një komunitet që i përket minoritetit grek, i shtrirë kryesisht përgjatë kufirit me shtetin grek. Lëvizjet migratore brenda këtij rrethi gjyqësor, kanë sjellë heterogjenizimin e komuniteteve lokale tradicionale, në një masë të konsiderueshme.

I përmendëm këto karakteristika kryesore, pasi mendojmë se ato ndikojnë drejtpërdrejt jo vetëm në strukturën e kriminalitetit në këtë rreth gjyqësor, por disa prej tyre edhe në veprimtarinë e organeve ligjzbatuese.

B) Zbatimi i objektivave prioritarë të Prokurorisë për vitin 2022

Zbatimi i objektivave prioritarë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, bëhet mbështetur në përcaktimet kushtetuese e ligjore, në kërkesat që burojnë nga përmbajtja e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, nga zbatimi i urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm si dhe në reflektimin lidhur me prioritetet për vitin 2022, të përcaktuara nga Rezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 304 datë 11.05.2022 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022”. Po kështu, objektivat prioritarë afatshkurtër e afatmesëm të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër për vitin 2022, janë diktuar nga faktorët kriminogjenë specifike të këtij rrethi gjyqësor, ndikimi i tyre në strukturën e kriminalitetit vendas dhe ndërkombëtar.

Më poshtë, po përmendim shkallën e realizimit të disa nga objektivat prioritarë për vitin 2021:

1) Garantimi i veprimtarisë së pavarur dhe të përgjegjshme të prokurorit.

Me ligjin nr. 35/2017, në Kodin e Proçedurës Penale u bënë disa ndryshime të cilat ndryshuan mënyrën e funksionimit të organit të prokurorisë, nga organ hirearkik i centralizuar, në organ të decentralizuar. Ndryshuan përcaktimet lidhur me vendimmarrjen e prokurorit, e cila u bë e pavarur dhe roli i prokurorit më të lartë u përqëndrua në drejtim të dhënies së udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, me pasoja vetëm afatgjatë në drejtim të vlerësimit profesional periodik të prokurorëve. Në vazhden e Reformës në Drejtësi, numri i prokurorëve, u ndryshua duke u reduktuar nga tre prokurorë që ushtronin funksionin në periudhën 01.01.2022 – 09.05.2022, në dy prokurorë (Julian Çafka dhe Ermira Manelli) për periudhën 09.05.2022 – 27.07.2022 për shkak të pezullimit të prokurorit Emrror Kasaj *ipso lege*, pasi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin përkatës u disponua për shkarkimin e tij nga detyra. Më pas, me vendimet përkatëse të Këshillit të Lartë të Prokurorisë u emëruan në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër prokuroret Denisa Plaku dhe Blerina Musabelliu dhe prej datës 27.07.2022 – 31.12.2022 në Prokurorinë Gjirokastër kanë ushtruar funksionin katër prokurorë. Ushtrimi i veprimtarisë me numër të reduktuar prokurorësh për pjesën më të madhe të vitit 2022 (me tre dhe dy prokurorë), ka sjellë për pasojë shtimin e vëllimit të veprimtarisë së tyre dhe për ta përballuar këtë ngarkesë, vështirësi në organizimin administrativ dhe veprimtarinë proçeduriale të institucionit.

Ndodhur në këto kushte, përsëri nga ana jonë janë marrë masa organizative me qëllim që jo vetëm të përballohet ngarkesa e punës, por edhe të përcaktohen dhe të ndiqen objektivat prioritarë të punës. Për rritjen e pavarësisë së prokurorit dhe përgjegjshmërisë së tij, fokusi është përqëndruar në këto çështje kryesore:

- Evidentimi i çështjeve penale të regjistruara nëpërmjet përdorimit të indekseve dhe tabelave përkatëse elektronike, për përpunimin e shpejtë të të dhënave.
- Shortimi elektronik i çështjeve, bazuar në nenin 53, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 97/2016 “ Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në pikën 1 të Kreut II dhe pikën 3 të Kreut III të Udhëzimit nr. 3 datë 29.12.2016 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.
- Evidentimi i problematikave të veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe i shërbimeve mbështetëse, duke marrë masat që puna e prokurorit të zhvillohet normalisht dhe pa krijuar subjektet e sipërcituara pengesa në punën e prokurorit.
- Trajtimi i ankesave dhe kërkesave për informim të shtetasve në afatin e përcaktuar, duke marrë parasysh që trajtimi i ankesës dhe dhënia e informacionit të bëhet brenda afateve ligjore nga prokurori i çështjes konkrete.

- Shqyrtimi i ankesave nga Drejtuesi i Prokurorisë në rastet kur çështjet adresohen tek ai.
- Përzgjedhja e temave trajnuese dhe pjesëmarrja si fizike, ashtu edhe online në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës.
- Bërja e analizave në çështjet konkrete nga prokurori e oficeri i policisë gjyqësore dhe informimi i Drejtuesit të Prokurorisë.
- Krijimi i raporteve të besimit me policinë gjyqësore, në rastin e kryerjes së hetimeve proaktive, disponimi i prokurorit me akte të qarta, të sakta e në përputhje me ligjin për kryerjen e këtyre veprimeve.
- Normimi i procedurave të trajtimit të shkeljeve të mundshme disiplinore në institucion.

Për të gjitha këto çështje të evidentuara, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër janë marrë masa, të cilat përmbledhen në:

- Zbatimin e Rregullores së Brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër në lidhje me disa nga çështjet e sipërcituara.
- Nxjerrja nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër e Udhëzimit të Përgjithshëm Administrativ nr. 1 datë 19.12.2022 *“Për mbikqyrjen e disiplinës së punonjësve të prokurorisë dhe marrjen e masave për ndjekjen e rasteve konkrete”*.
- Në zbatim të udhëzimit të sipërcituar, krijimin e Komisionit të Verifikimit të Shkeljeve Disiplinore.
- Operativiteti në krijimin e sistemeve elektronike të të dhënave dhe krijimi i regjistrave manuale përkatës.
- Trajtimi i Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, duke i trajtuar ato në mbledhje periodike dhe nxjerrja e urdhërave në zbatim të tyre.
- Organizimi i brendshëm i punës ku çdo prokurori i caktohet një officer i policisë gjyqësore të seksionit dhe një sekretare për të ushtruar veprimtarinë.

Problematika e ngarkesës së lartë në punë, duke qenë se numri i prokurorëve është shtuar në gjysmën e dytë të vitit 2022, ka ardhur drejt reduktimit dhe sfida e organit të prokurorisë është përshpejtimi i ritmit dhe arritja e normalitetit të ngarkesës së punës për secilin prokuror. Objekt final gjithashtu është zgjidhja përfundimtare e çështjeve të mbartura në vite nga shkaku objektiv i ndërrimit të shpeshtë të prokurorëve që i kanë trajtuar ato. Shtimi efektiv i numrit të prokurorëve ka sjellë për pasojë edhe trajtimin më të shpejtë të kërkesave procedurale të palëve duke krijuar kushte pozitive për rritjen e imazhit të institucionit dhe të secilit prokuror. Raporti i drejtë përsa i përket shpejtësisë së trajtimit të kërkesave të publikut dhe të subjekteve procedurale, përfaqëson një proces që gjeneron një pozitë të drejtë të institucionit e të çdo prokurori e punonjësve të tjerë në raport me publikun dhe ndikon në mënyrë direkte në eliminimin e sulmeve mediatike apo publike të cilat shpesh më parë janë ndërmarrë pa marrë parasysh faktorët objektivë pengues.

Garantimi i pavarësisë së prokurorit është e lidhur edhe me rritjen e përgjegjshmërisë së tij. Në pamje të parë duket sikur këto dy komponentë janë antagonistë, por përvoja ka treguar se çdo lloj cedimi në veprimtarinë e rregullt e të normuar drejt prokurorit, ndikon direkt në pavarësinë e tij. Prandaj është parë e nevojshme që mbikqyrja institucionale të jetë si “rojë”, me qëllim ndërgjegjësimin e secilit punonjës e veçanërisht atyre në funksionin e prokurorit. Në këtë kuadër, është parë e nevojshme të normohet procedura e konstatimit, evidentimit, ndjekjes dhe sanksionimit të shkeljeve disiplinore për punonjësit e prokurorisë dhe evidentimit, sigurimit të provave dhe njoftimit të organeve respektive për prokurorët e oficerët e policisë gjyqësore. Normimi i mëtejshëm i procedurave të sipërcituara është bërë me udhëzimin nr. 1 datë 19.12.2022 *“Për mbikqyrjen e disiplinës së punonjësve të prokurorisë dhe marrjen e masave për ndjekjen e rasteve konkrete”*. Bazuar në këtë udhëzim, është krijuar Komisioni i Verifikimit të Shkeljeve Disiplinore dhe të dhënat e veprimtarisë plotësohen në Regjistrin e

Evidentimit të Shkeljeve Disiplinore. Proçesi i evidentimit e trajtimit të shkeljeve, udhëhiqet nga parimi i propocionalitetit dhe parimi i efijencës, që të zbërthyer në këtë fushë kanë domethënien e zhvillimit kryesisht të frymës edukuese në punë dhe zgjidhjen e problematikave të rëndësisë së ulët pa kaluar në mjete represive. Kryesisht është konceptuar që proçesi disiplinor të jetë “*ultima ratio*” dhe “*extrema ratio*”, kur mjetet e tjera si gjetja e shkakut të sjelljes jo korrekte dhe krijimi i mekanizmave të respektimit nuk kanë dhënë rezultat.

- 2) Rritja e efijencës dhe e bashkëpunimit ndërinstytucional në çështjet e parandalimit të pastrimit të parave apo të hetimeve pasurore.

Si me hetimin e veprave penale të parashikuara nga nenet 287 dhe 287/b i K.Penal, ashtu edhe në zhvillimin e hetimeve pasurore, në kuadrin e proçedimeve penale apo të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, janë mbajtur parasysh problematikat e hasura në hetime në vitet e mëparshme, por edhe nevoja për rritje të efijencës.

Karakteristikat e hasura gjatë veprimtarisë hetimore, që diktojnë trajtimin si prioritet të këtyre çështjeve, në rrethin gjyqësor Gjirokastër, janë:

- Lufta kundër informalitetit.
- Zgjerimi i veprimtarisë kriminale edhe jashtë kufijve shtetërorë.
- Nevoja për bashkëpunim ndërinstytucional në hetimin e këtyre veprave penale.

Duke marrë në konsideratë raportet periodike vjetore të agjensive ndërkombëtare dhe kombëtare, diktuar edhe nga struktura e kriminalitetit në vendin tonë, janë marrë një sërë masash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim luftimin e veprimtarisë së pastrimit të produkteve të veprës penale. Me ligjin nr. 8646 datë 20.07.2000, është ratifikuar Konventa Europiane “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”. Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga proçesi i integritetit europian të vendit tonë, Komiteti i Stabilizim Asocimit ka dhënë disa rekomandime për zhvillimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit. Në zhvillimin e veprimtarisë së agjensive ndërkombëtare, në fokus janë vendosur rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar(FATF). Në këtë aspekt, për përmbushjen e rekomandimeve, janë hartuar plane veprimi në nivel ndërkombëtar si ICRG/FATF, por edhe plane veprimi në nivel kombëtar me qëllim përmirësimin e metodologjive të hetimit, rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional e bashkërendimit të të dhënave dhe dixhitalizimit të tyre.

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit, është vendosur si një ndër prioritetet edhe nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën e miratuar “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021” si dhe nga Këshilli i Ministrave në rekomandimet prioritare të miratuara me vendimin nr. 304 datë 11.05.2022.

Për përmbushjen me sukses të luftës kundër pastrimit të produkteve të veprës penale dhe financimit të terrorizmit, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 10 datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe proçeduriale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizimit dhe në hetimet pasurore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”. Në zbatim të këtij udhëzimi, është nxjerrë urdhëri nr. 2 datë 04.09.2020 “Për caktimin e prokurorit për hetimin e çështjeve penale që lidhen me pastrimin e parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe për kryerjen e hetimeve pasurore”. Për hetimin e këtyre çështjeve penale, është caktuar prokurorja Ermira Manelli, e cila me po të njëjtin urdhër, është caktuar edhe pikë kontakti për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër për shkëmbimin e informacionit sipas regjistrimit Etracking Presto. Për shkak të numrit të reduktuar të prokurorëve, çështjet kanë vazhduar të hetohen nga të gjithë prokurorët, kurse profilizimi është ruajtur vetëm në lidhje me raportimin statistikor.

Udhëzimi nr. 10 datë 17.07.2020 i Prokurorit të Përgjithshëm udhëzon zbatimin e një sërë rregullash administrative e proceduriale, të cilat konsistojnë në:

- Raportimet periodike nëpërmjet trasmetimit të database on-line me treguesit statistikore, nëpërmjet regjistrit elektronik e-tracking Presto.
- Profilizimit të magistratëve në hetimin e krimeve në fushën financiare e ekonomike dhe trajnimi i mëtejshëm i tyre.
- Bashkëpunimit ndërinstitucional në shkëmbimin e të dhënave të vlefshme për hetimet.
- Rritja e efikasitetit të punës, nëpërmjet normimit të veprimtarisë brenda afati të caktuar.

Në zbatim të drejtimeve të sipërcituara dhe atyre që diktohen nga tërësia e akteve të sipërcituara, nga ana jonë janë marrë një sërë veprimesh që konsistojnë në:

- Përzgjedhjen e trajnimeve që kanë tematikë hetimin e këtyre grup veprash penale.
- Përmbytjen e detyrimeve të raportimit periodik në Prokurorinë e Përgjithshme të të dhënave të përmbajtura në regjistrin elektronik e-tracking Presto.
- Sigurimin e konsulencës financiare lidhur me transaksione , të ardhura e shpenzime, për nxjerrjen e konkluzioneve të vlefshme për hetimet, nëpërmjet kryerjes së ekspertimeve ekonomike.
- Aksesimi në sisteme online të ASHK, sistemi Tims, sistemi ASF 2, sistemi E-gjoba, në Regjistrin Notal Shqiptar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, E-Albania dhe në Regjistrin e Llogarive Bankare.
- Kryerja e hetimeve paralele të pasurisë së bashku me hetimet për veprat e tjera që krijojnë të ardhura.
- Zhvillimi i mardhënieve juridiksionale me autoritetet gjyqësore të shteteve të tjera.

Si problematika do të veçonim:

- Shkalla e lartë e informalitetit edhe në ekonominë lokale, sjell vështirësi në procesin e të provuarit.
- Mungesën në këtë drejtim të hetimeve proaktive. Zakonisht referohen aktet për veprat penale të parashikuara nga neni 287 i K.Penal, shumë kohë pasi veprimtaria e paligjshme ka marrë zgjidhje ligjore dhe nuk merren të dhëna aktuale për veprimtarinë e paligjshme që zhvillohet, për financimin aktual të një veprimtarie ekonomike me paratë e rrjedhura nga vepra penale, për personat apo kompanitë që mbulojnë apo fshehin veprimtarinë e paligjshme, për bashkëpunimin transkufitar të delikuentëve.
- Ngarkesa e punës ka bërë që hetimet të mos zhvillohen me shpejtësi dhe kthimi i përgjigjeve për marrjen e informacionit nuk ka qenë në kohën e duhur.
- Zakonisht administrohen në fashikullin e procedimit penal të gjithë përgjigjet e marra nga institucionet, duke sjellë për pasojë rritjen artificialisht të volumit të akteve.
- Mosfunksionimi i gjithë sistemeve online për marrjen e të dhënave, pasi Regjistri i Llogarive Bankare nuk është aktiv, kurse ASHK nuk mund të japë gjithë informacionin e kërkuar, pasi shumë pasuri nuk janë vendosur në sistem hartografik dixhital dhe në regjistrimet përkatëse, por aksesohen manualisht. Gjithashtu, sistemet e tjera kanë periudha mosfunksionimi herë pas here.
- Ndryshimi i herë pas hershëm i oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve passjell zvarritje artificiale dhe kohëzgjatje të pajustificuar të veprimeve hetimore.

Lidhur me këto problematika, ato janë bërë prezente në takime me drejtuesit e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjyqësore dhe është rënë dakord që të rritet numri i hetimeve proaktive, të rritet shumëllojshmëria e metodave speciale të hetimit, të kihet kujdes me sekretin hetimor si dhe të selektohet e të merret më shpejt fillimisht informacioni i frytshëm për hetimet, duke përdorur edhe sistemet online për identifikimin e tij. Ka rezultate të dukshme në hetimet proaktive që kanë të bëjnë me krimet në sferën ekonomike, por sfida ngelet arritja e

rezultateve në hetimin e zgjidhjen e çështjeve penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 287 dhe 287/b si dhe për hetimet pasurore të ndërmarra sipas ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

3) Zbatimi i alternativave të dënimit me burgim dhe i procedurave të reja për zgjidhjen e çështjeve penale.

Nën domosdoshmërinë për përmbushjen e qëllimeve që dënimi penal duhet të ketë, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër në individualizimin e dënimeve janë mbajtur parasysh këto parime:

- Parimi i proporcionalitetit
- Parimi i humanizmit
- Parimi i drejtësisë restauruese

Zakonisht, për autorët e mitur, për të sëmuret, të moshuarit, për autorët jo përsëritës specialë apo të përgjithshëm, për autoret femra dhe për vepra penale me rrezikshmëri konkrete të ulët, janë aplikuar në masë dënimet alternative. Nga dënimet alternative, më shumë është aplikuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit dhe vënia në provë sipas nenit 59 të K.Penal, duke vendosur shpesh edhe detyrimi për të dënuarin sipas nenit 60 të K.Penal. Në raste të caktuara është aplikuar edhe neni 63 i K.Penal, i cili për autorët e veprave penale, ka patur avantazhin e rehabilitimit të shpejtë, çka është vlerësuar nisur nga prognoza pozitive për sjelljen e tyre në të ardhmen.

Dënimet alternative nuk janë zbatuar në rastet kur autori ka qenë përsëritës special, kur veprat kanë patur një rrezikshmëri konkrete të konsiderueshme dhe në prani të rrethanave rënduese.

Vlerësimi i rrezikshmërisë konkrete të veprave penale dhe autorëve të tyre, nuk është bërë sipas një vlerësimi të ngurtë e abstrakt, por i vendosur brenda kontekstit të mardhënieve shoqërore në rrethin gjyqësor Gjirokastër, duke identifikuar faktorët kriminogjenë që nxisin dhe faktorët që frenojnë kriminalitetin, duke vlerësuar intesitetin me të cilin shkelen mardhëniet juridike dhe faktorët që e kanë diktuar shkeljen e normës, duke evidentuar ndjeshmërinë shoqërore ndaj fenomenit, përhapjes së tij dhe qortimit social të shëndoshë, duke marrë përgjegjësi të përbashkëta jo vetëm autori në kryerjen e veprës, por edhe shoqëria për integrimin e tij.

Në këtë aspekt, nga ana jonë është ndjekur në raste të caktuara një politikë dënimi e ndërthurur, e cila mban parasysh si ndjeshmërinë publike për fenomenet, ashtu edhe parimet e humanizmit dhe arritjes së qëllimit të dënimit.

Ndër shembujt e zhvillimit të kësaj politike penale të shkallëzuar e të ndërthurur, janë rastet e caktimit të dënimit të autorëve të veprave penale të parashikuara nga nenet 283/1, 284/1, 298, 130/a/1, 150 të K.Penal etj. Në këto raste, kur rrezikshmëria konkrete e veprës penale dhe shkalla e përhapjes së saj është jo e ulët, dënimi është vuajtur pjesërisht nën masë sigurimi me privim të lirisë personale(nenet 237 e 238 të K.Pr.Penale) dhe më pas në përfundim të gjykimit, është aplikuar edhe dënimi alternativ. Në varësi të lëvizjes drejt kahut të poshtëm apo të sipërm të rrezikshmërisë, dënimi është vuajtur vetëm në një mënyrë të vetme, ose plotësisht me privim lirie, ose plotësisht në liri.

Në rastin e dhunë në familje, në raste të caktuara mes autorit dhe familjarit të tij shpesh është arritur normalizim mardhëniesh. Në këto raste, nga ana jonë janë analizuar faktet nëse vepra ka qenë e përsëritur, shkalla e konfrontimit dhe motivet e tij etj dhe në varësi të tyre, është mbajtur qëndrimi më i butë me aplikimin e masave alternative, ose masa më të ashpra në rast të kundërt. Ndërkohë, në veprat penale me viktimë fëmijë, dënimet gjithmonë kanë tentuar

drejt ashpërsimit dhe mosaplikimit të dënimeve alternative, ç'ka vjen në përputhje edhe me rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave.

Në veprat penale kundër pasurisë, është mbajtur parasysh rrethana e zhdëmtimit të viktimës së veprës penale nga autori i saj. Po kështu edhe në veprat penale të kryera nga pakujdesia kjo rrethanë është mbajtur parasysh kjo rrethanë lehtësuese.

Dënimet me gjobë janë zbatuar në rastet e veprave penale të cilat parashikojnë këtë dënim, kryesisht për veprat penale të lehta, kundravajtje, parashikuar nga nenet 297, 179/a, etj.

Lidhur me zbatimin e gjykimeve të posaçme, janë zbatuar gjykime të drejtpërdrejta në rast dhe në masë është zbatuar gjykimi i shkurtuar si dhe janë miratuar urdhëra penale dhe janë zhvilluar gjykime me marrëveshje. Për këtë qëllim, janë mbajtur parasysh kërkesat për gjykim të shpejtë e të drejtë, duke aplikuar këto forma të reja të zgjidhjes së çështjeve penale.

Nga tërësia e dënimeve të kërkuara e të vuajtura, evidentojmë këto problematika:

- Nuk parashikohen masa rieduktimi konkrete për të miturit në konflikt me ligjin.
- Nga marrja e vendimit formë të prerë, deri në arsyetimin e vënien në dispozicion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjyrokastër të tij, kalon një kohë e gjatë dhe mund të ndodhë që i dënuari të qëndrojë në paraburgim, në pritje të nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit.
- Pas vuajtjes së dënimit, i dënuari zakonisht gjendet në një vakum social, çka e bën që të marrë përsëri rrugën e nisur më parë.

Lidhur me këto probleme, së pari mendojmë se për të miturit duhet të parashikohen masa të posaçme riedukuese, të cilat diktojnë nevojën e shtimit të dispozitave në legjislacionin tonë. Së dyti, në lidhje me vonesat në arsyetimet e vendimeve të Gjykatës së Apelit, me shkresë i jemi drejtuar kësaj gjykate duke kërkuar që arsyetimi i vendimeve, të paktën për personat që janë në paraburgim, të bëhet në kohë sa më të shpejtë. Lidhur me personat e dënuar, të cilët pasi vuajnë dënimin, rikthehen në shoqëri, do të ishte mirë që legjislatori të parashikonte masa ndihmëse, me qëllim që këta persona të kenë mundësi konkrete riintegrimi.

4) Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Me ligjin nr. 43/2021, janë bërë ndryshime në Kodin Penal. Është ndryshuar neni 259 i K.Penal, i bërë me dy paragrafë, ku paragrafi i parë parashikon aktin korruptiv deri në vlerën 50 000 lekë, kurse paragrafi i dytë mbi këtë vlerë. Me ligjin nr. 41/2021, është ndryshuar neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, duke përcaktuar kompetencën për gjykimin në Gjykatën Kundër Krimit të Organizuar e Korrupsionit (në vazhdim Prokuroria e Posaçme) vetëm për paragrafin e dytë të nenit 259 të K.Penal, kurse paragrafi i parë i takon juridiksionit të përgjithshëm.

Nga data 01.06.2021, kur neni 7 i ligjit 41/2021 me të cilat janë bërë ndryshime në procedurë, nuk ka patur referime apo kallëzime për veprën penale të parashikuar nga neni 259 paragrafi i parë i Kodit Penal.

Nga ana jonë janë hetuar kryesisht raste të cilat kanë të bëjnë me pretendimet për veprime abuzive të organeve shtetërore apo punonjësve të veçantë. Në këto raste, nuk është vërtetuar kryerja e veprimeve korruptive, ndërkohë që për veprime për të cilat ka patur dyshime për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, në rastet kur subjekti ka rezultuar se ka qenë nga ato që janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar e Korrupsionit, çështja ka kaluar në këtë prokurori.

Nuk ka patur raste të referuara apo që kanë rezultuar gjatë hetimeve për forma të bashkëpunimit të posaçëm në format e parashikuara nga neni 28 i K.Penal.

Lidhur me zbatimin e Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional, me nr. 8126 datë 15.12.2020 të lidhur mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, vlen të theksohet se në kuadrin e koordinimit e të bashkëpunimit, mes prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe Prokurorisë së Posaçme raportet kanë qenë në këto drejtime:

- Në drejtim të dhënies së informacionit dhe kopje të akteve për çështje të caktuara Prokurorisë së Posaçme nga ana jonë;
- Në drejtim të marrjes së informacionit dhe kopjes së akteve Prokurorisë së Posaçme, në hetimin kryesisht të veprave penale të parashikuara nga neni 287, 287/b të K.Penal, apo hetimeve pasurore.
- Në disponimin për shpallje moskompetence dhe kalimin e akteve për 3 raste të procedimeve penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër në Prokurorinë Speciale.
- Në përcjelljen për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër të kallëzimeve penale nga Prokuroria e Posaçme në 6 raste.

5) Bashkëpunimi ndërinstitucional

Në zhvillimin e veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, për ushtrimin e kompetencave të parashikuara me ligj, një nga orientimet prioritare për vitin 2022 e në vazhdim, është thellimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, i cili konsiston në këto drejtime:

- Shkëmbimi i të dhënave me Prokurorinë e Përgjithshme, në kuadër të mardhënieve juridikionale me jashtë apo për verifikimin e personalitetit të shtetasve.
- Marrja e aksesit në database të institucioneve shtetërore, me qëllim që të rritet efienca dhe shpejtësia në hetimin e veprave të caktuara penale.
- Koordinimi me institucionet shtetërore me qëllim filtrimin e informacionit të kërkuar dhe krijimin e një qasjeje koherente në luftën kundër trafikëve të ndryshme apo kultivimit të bimëve narkotike.
- Bashkëpunimi me prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm e prokurorinë speciale, në hetimet e kryera dhe në shkëmbimin e informacionit.
- Bashkëpunimi me shërbimet e policisë gjyqësore, duke orientuar rritjen e përgjegjshmërisë së tyre dhe profesionalizimit.
- Bashkëpunimi me njësitë vendore dhe shoqata të ndryshme, për trajtimin e subjekteve të posaçëm(të mitur, viktimat të trafikimit të qënieve njerëzore, viktimat fëmijë e femra).
- Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për organizimin e trajnimit vazhdues të magjistratëve.
- Njoftimi i inspektoriateve të institucioneve të ndryshme, kur fakti ose cilësohet qysh në fillim ose rezulton më vonë që nuk ka element të figurës së veprës penale, por mund të përfaqësojë kundravajtje administrative.

Në kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë e Mardhënieve Juridikionale me Jashtë, në Prokurorinë e Përgjithshme, shkëmbimi i informacionit është realizuar jo vetëm nëpërmjet komunikimit shkresor, por edhe komunikimit nëpërmjet postës elektronike, në adresat zyrtare respektive, çka ka bërë që informacioni të merret në kohë më të shpejtë, të evidentojë problematikat dhe të jetë shterues. Ky informacion është shkëmbyer në rastet e ndjekjes së procedurave të ekstradimit për jashtë shtetit, duke verifikuar nëse personi që do të ekstradohet ndiqet penalisht apo ka dënim për të vuajtur në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në rastet e komunikimit të akteve të kërkesave për ekstradim apo të kërkesave të tjera të përcjella nga autoritetet e huaja.

Një nga format e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, është rritja e aksesit të prokurorëve në database të institucioneve shtetërore. Kështu, është siguruar akses në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, ku konsultohet informacioni në lidhje me pasuritë e paluajtshme në kohë reale. Po kështu, shkëmbimi i informacionit nëpërmjet sistemit Tims, aksesit në regjistrat e gjendjes civile, në verifikimin e gjendjes gjyqësore, në portalin E-Albania dhe në Regjistrin Noterial Shqiptar, përfaqëson një zhvillim shumë pozitiv të rritjen e shpejtësisë dhe efikasitetit së prokurorisë në hetimin e veprave penale. Si problematikë theksohet fakti që me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 389 datë 13.05.2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, është përcaktuar se shërbimet ndaj organit të prokurorisë kryen me pagesë. Mendojmë se për veprimtari të shkëmbimit të informacionit mes institucioneve shtetërore pagimi i tarifës, qoftë edhe pa parapagim si në rastin tonë, është i tepërt.

Me vendimin nr. 248 datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave, është miratuar një plan veprimi kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit për vitet 2017-2020. Në kuadrin e bashkëpunimit me institucionet e tjera, në datën 29.06.2017, është miratuar marreveshja e bashkëpunimit mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku parashikohej koordinimi dhe bashkëpunimi në luftën kundër kultivimit e trafikimit të bimës narkotike cannabis sativa mes shumë institucioneve. Në zbatim të saj, Prokurori i Përgjithshëm me urdhërin nr. 145 datë 29.06.2017, urdhëroi që të vihej në zbatim ky bashkëpunim duke caktuar nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm një përfaqësues në task-force të krijuar për këtë qëllim. Nga ana jonë, është caktuar si përfaqësuese në task-force prokurorja Ermira Manelli. Aktet rregulluese të krijimit e ekzistencës së këtij bashkëpunimi kanë qenë limituar deri në vitin 2020. Pavarësisht këtij kuadri rregullash bashkëpunimi, është mëshuar në takimet me Drejtorinë Vendore të Policisë Gjyqësore që të shfrytëzohet bashkëpunimi dhe të merret informacion e të zhvillohen takime me Prefektin e Qarkut, Shish, OSHEE, Njësitë Vendore, Ujells-Kanalizime, Drejtorinë të Shërimit Pyjor, etj. Duhet evidentuar se ky bashkëpunim paraqet këto avantazhe:

- Shkëmbimi i informacionit mes institucioneve skanon më mirë veprimtaritë e paligjshme të kryera apo që do të kryhen.
- Parandalon përhapjen e fenomenit.
- Informacioni filtrohet dhe saktësohet në kohë të shpejtë.
- Nxit pjesëmarrjen e komunitetit në luftën kundër këtij fenomeni.

Problematikat e hasura në këtë bashkëpunim kanë qenë:

- Në disa raste kuptimi jo i drejtë i qëllimit të bashkëpunimit, pasi është kuptuar shpesh ky bashkëpunim si tentim për shmangie përgjegjësie nga njëri institucion tek tjetri.
- Përfaqësuesit shpesh kanë vendosur objektiva maksimale, pa analizuar shkaqet e fenomenit dhe mungesës së qasjes strukturore ndaj tij.
- Nuk ka patur një koordinim të saktë për filtrimin e informacionit.

Do të sygjerojmë që të ripërtërihet kuadri ligjor i bashkëpunimit edhe për një periudhë tjetër, duke qenë se e vlerësojmë frytdhënës koordinimin e institucioneve të ndryshëm në realizimin e objektivave përkatës.

Lidhur me bashkëpunimin me prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm apo prokurorinë speciale, vlen të theksohet se bashkëpunimi ka konsistuar në këto drejtime:

- Në disponimin për kompetencën për shkak territori apo lënde.
- Në shkëmbimin e informacionit dhe akteve për procedimet konkrete.

Bashkëpunimi me shërbimet e policisë gjyqësore, përveç kompetencave ligjore, ka konsistuar edhe në këto drejtime:

- Zhvillimi i takimeve formale e informale, ku janë ngritur problematika konkrete të punës.

- Koordinimi lidhur me probleme të cilat kanë lindur në çështje konkrete, ku është nevojitur bashkëpunim me institucione të treta, për trajtimin e viktimave, për ekzekutime masash, për trajtimin e të miturve.
- Dhënia e udhëzimeve përkatëse, në rastet e zhvillimit të proceseve të caktuara, me impakt në shoqëri.

Kryerja e veprimeve të para hetimore dhe e veprimeve të ngutshme si dhe marrja e kallëzimeve penale nga shtetasit, në pjesën dërrmuese është realizuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjyrokastër.

Me Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është rënë dakord të zgjidhen në një mënyrë të re trajtimi, duke respektuar të drejtat e subjekteve, faktet që lidhen me zbatimin e nenit 59 të K.Penal dhe ato që dukshëm nuk përmbajnë elementë të figurës së veprës penale. Në zbatim të këtij memorandumi, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë Udhëzimin e Përgjithshëm nr.15 datë 30.10.2020, ku përcaktohet procedura e trajtimit të këtyre rasteve.

Për zbatimin e këtij memorandumi, nga ana jonë janë marrë këto masa:

- Janë zhvilluar trajnime me oficerët e policisë gjyqësor të shërbimeve të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjyrokastër.
- Është krijuar regjistri i evidentimit të rasteve që lidhen me veprat penale që procedohen sipas nenit 59 të K.Penal apo që dukshëm nuk përmbajnë elementë të figurës së veprës penale.

Zbatimi i procedurës sipas përcaktimeve të akteve të sipërcituara, ka sjellë dobi në veprimtarinë e Prokurorisë në këto drejtime:

- Është ulur ngarkesa artificiale e punës, pasi rezultojnë se janë trajtuar me këtë memorandum 95 raste për vitin 2022.
- Realizimi i të drejtave të palëve është orinetuar më drejt, duke adresuar direkt organin kompetent për zgjidhjen e konfliktit.
- Nuk janë cënuar të drejtat e personave, pasi në rast kundërshtimi nga ata, është mbajtur parasysh që personave t'u sigurohet kontrolli gjyqësor.

Në lidhje me subjektet e posaçëm, me vendimin nr. 1 datë 12.06.2019, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër është zgjedhur koordinatori i posaçëm, bazuar nënin 80 të ligjit nr. 97 /2016 “Për organizmin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Në përmbushje të funksioneve që diktohen nga ky pozicion, janë ndërmarrë veprime në këto drejtime:

- Pjesëmarrja në takime të organizuara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, për implementimin e programeve të caktuara në bashkëpunim me shoqata jofitimprurëse, si Save Albania dhe Qendra e Shërbimeve e Praktikave Ligjore të Integruara, të cilat japin ndihmë juridike, psikologjike, ndërmjetësim për të mitur.
- Bashkëpunimi me zyrën e Shërbimit Social në Njësitë Vendore, me qëllim asistimin me ndihmë materiale dhe jomateriale për subjektet e posaçëm(të mitur në konflikt me ligjin apo viktimë të mitur apo femra, persona me aftësi ndryshe, viktimë të trafikëve, emigrantë nga vendet Mena etj).
- Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme, të cilat fokusohen në problematika në lidhje me subjektet e posaçëm.
- Koordinimi për dhënien e ndihmës së viktimave të dhunë seksuale.

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues për vitin 2022 konsistoi:

- Në përzgjedhjen e temave sipas drejtimit që mbulojnë prokurorët (për të mitur, për krimet në fushën financiare, lidhur me ekzekutimet etj).

- Në pjesmarrjen në trajtimet e zhvilluara në mënyrë aktive.
Ndjekja e programit të trajnimeve vazhduese, ka sjellë përfitim jo vetëm për përmirësimin e përgatitjes teorike të prokurorëve, por edhe për zbatimin e njohurive në praktikë.

6) Respektimi i të drejtave të njeriut

Zhvillimi i veprimtarisë procedurale e administrative të prokurorisë, është i orinetuar në çdo rast në respektimin e të drejtave të njeriut. Kjo prerogativë, nënkupton respektimin e këtyre të drejtave në këto drejtime:

- respektimi i të drejtave të subjekteve procedurale
- respektimi i së drejtës për informim të shtetasve
- respektimi i privacy, sidomos i të miturve, kur kjo e drejtë prevalon në raport me të drejtën e informimit.
- respektimi i të drejtave jo vetëm në aspektin negativ, por edhe marrja e masave në përmbushje të detyrimit pozitiv për hetimin e rasteve të shkeljes së të drejtave.

Në respektimin e të drejtave të subjekteve procedurale, nga ana e prokurorisë, janë marrë këto masa në çdo rast:

- Sigurimi i mbrojtjes me mbrojtës kryesisht kur janë rastet e parashikuara me ligj.
- Sigurimi i asistencës psikologjike për subjekte të posaçëm si të mitur, të rinj, viktime të dhunës familjare opo të trafikimit.
- Asistimi dhe koordinimi i koordinatorit të posaçëm ndaj subjekteve të pëcaktuara në nenin 68 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Trajtimi i viktimave të veprave penale, duke ofruar kontakte me organizata joqeveritare, shërbime mbështetëse në njësitë vendore dhe ofrim i ndihmës juridike e psikologjike falas nga organizata të caktuara.

Në respektimin e së drejtës për informim, nga ana e prokurorisë janë marrë këto masa:

- Komunikimi me publikun dhe mediat bëhet sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në Udhëzimin nr. 5 datë 30.07.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mardhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” dhe në udhëzimin nr. 1 datë 19.05.2020 i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjyrokastër “Për rritjen në vazhdimësi të efektivitetit të kontrollit të disiplinës në punë”.
- Është krijuar regjistri I komunikimit të kërkesave dhe dhënies së informacionit, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014.
- Komunikimi si rregull bëhet me shkrim, duke afishuar në ambiente të dukshme të prokurorisë edhe rregulla të detajuara për kërkimin dhe marrjen e informacionit.
- Për subjektet e procedimeve penale, informimi bëhet nga çdo prokuror që ndjek çështjet konkrete, kurse për çështjet e përfunduara, informimi bëhet me urdhër të drejtuesit të prokurorisë.

Në respektimin e jetës private, sidomos për të miturit në konflikt me ligjin apo viktime të veprave penale, janë marrë këto masa:

- Kërkesa e organit të prokurorisë për zhvillimin e gjykimeve me dyer të mbyllura.
- Reduktimi i dhënies së informacionit për këto çështje që lidhen me këto subjekte.
- Afishimi i njoftimeve për regjistrim filmik me kamera të ambienteve të prokurorisë.

Ndër veprimet pozitive të ndërmarra nga organi i prokurorisë për evidentimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, përmendim:

- Nisjen e procedimeve penale kur është pretenduar keqtrajtim i personave të proceduar nga punonjës të policisë.

- Sigurimi që në përputhje me Rekomandimet e Avokatit të Popullit(në përputhje me Rekomandimet e Komitetit European për Parandalimin e Torturës), hetimi i procedimeve penale të pretenduara për dhunë policore, të mos ndiqet nga i njëjti prokuror që ndjek çështjen ku subjekti i dhunuar është proceduar fillimisht.
- Diskutim në mbledhjen e prokurorëve që të marrin kontakt dhe të jenë vigjilentë për çdo rast dhune të pretenduar nga të arrestuarit, të shoqëruarit apo të ndaluarit, duke kërkuar ekspertizë mjeko-ligjore në rastet e pretenduara.
- Diskutimi me shërbimet e policisë gjyqësore, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre për trajtimin e të dyshuarve, shkurtimin e orareve të gjata të marrjes në pyetje, eliminimin e pyetjes së tyre në orare të papërshtatshme, shkurtimin e orarit të shoqërimit të personave, sigurimin e kontaktit të shpejtë me mbrojtësit dhe sigurimi i kushteve bazike këtyre personave.

Vlen të theksohet që nuk ka patur raste të evidentimit të dhunës, por ka dy raste nën hetim, pasi organi i prokurorisë kërkon që rasteve të pretenduara, t'u bëjë një hetim shterues të të gjitha pretendimeve të ngritura. Përgjithësisht është vërejtur një nivel i kënaqshëm nga të gjithë organet ligjzbatuese në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut. Kjo është vërejtur sidomos edhe në trajtimin e viktimave të veprave penale, ku bashkëpunimi prokurori-polici – njësi vendore, ka bërë që rastet të marrin trajtim të plotë, duke zgjidhur çështje si strehimi, ushqyerja, asistenca juridike, psikologjike, mjekësore etj.

7) Një tablo e përgjithshme e gjendjes së kriminalitetit dhe e masave të marra në zbatim të rekomandimeve prioritare.

Lidhur me ecurinë e zbatimit të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2022 dhe të planit të veprimit të miratuar me urdhërin nr. 56/2022, të shoqëruar me treguesit statistikorë, së bashku me shpjegimet mbi angazhimet, arritjet dhe problematikat, rezulton se:

- Në lidhje me masat administrative të marra sipas ligjit për nxjerrje udhëzimi të përgjithshëm dhe/ose plan veprimi për marrjen e masave në përputhje me gjendjen e kriminalitetit, me qëllim sigurimin e zbatimit të rezolutës së Kuvendit:
 - Në lidhje me zbatimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, duke patur parasysh ngarkesën e lartë në punë dhe numrin e reduktuar të prokurorëve për pjesën më të madhe të vitit 2022, është mbajtur parasysh që zbatimi i kërkesave të rezolutës e në të njëjtin drejtim edhe i planit të veprimit të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa nxjerrë udhëzime të përgjithshme apo plane veprimi të prokurorisë.
 - Prokurorët janë njohur me kërkesat e rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2021”, miratuar në datën 14.07.2022 dhe me urdhërin nr.56 datë 29.07.2022 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.07.2022”.
 - Në mbledhjen e prokurorëve janë diskutuar problematikat konkrete të veprimtarisë së prokurorisë në drejtim të plotësimit të kërkesave sipas përcaktimeve të Rezolutës, masat që duhet të merren në drejtim të plotësimit të kërkesave të saj dhe bashkëpunimi ndërinstitucional si komponent thelbësor në prespektivën e plotësimit të tyre.
 - Në mbledhjet me shërbimet e policisë gjyqësore është vënë theksi tek kërkesa për rritjen e efikasitetit në hetimet pasurore apo të krimeve në sferën ekonomike e financiare, duke përzgjedhur drejt informacionin, përdorur metoda speciale të hetimit dhe duke siguruar një aksesim të shpejtë të të dhënave.
 - Krijimi i aksesit në database online për konsultimin e të dhënave ka çuar në nevojën e marrjes së të dhënave të domosdoshme për krijimin e aksesit dhe në korrespondencën

përkatëse me Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme. Është krijuar akses në shërbime për certifikata të gjendjes gjyqësore, në e-albania, në shërbimet e gjendjes civile, në sistemin Tims, në ASHK, në regjistrin e noterëve, por në regjistrin e llogarive bankare nuk është krijuar akoma akses, megjithëse secili nga punonjësit e autorizuar të prokurorisë sonë, është pajisur me user-name e passëord. Shpresojmë që kjo problematikë dhe mirëmbajtja e duhur e sistemeve të zgjidhen në të ardhmen. Sistemi Cams ka pasur probleme të filtrimit të informacionit.

- Për të siguruar rritjen e përgjegjshmërisë dhe pavarësisë së prokurorëve, është nxjerrë udhëzimi nr. 1 datë 19.12.2022 *“Për mbikqyrjen e disiplinës së punonjësve të prokurorisë dhe marrjen e masave për ndjekjen e rasteve konkrete”*, ku parashikohet në zbatim të ligjit nr. 97/2016, krijimi i komisionit të procedimit disiplinor dhe mbajtja e një regjistri gjurmimi të shkeljeve dhe shënimit të çdo hapi procedural të ndjekur deri në vendimarrjen përkatëse.
- b) Lidhur me rritjen e rolit të drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve për regjistrimin e procedimeve kryesisht apo numri i hetimeve proaktive, si dhe krahasimi i të dhënave me vitin 2021, vlen të theksohet se:
 - Zakonisht njoftimet për vepra të caktuara penale janë marrë nga mediat dhe me drejtuesit e shërbimeve të policisë gjyqësore është rënë dakord parimisht dhe në komunikimet konkrete që inicimi i çështjeve të caktuara të bëhet nga shërbimet e policisë gjyqësore, fakt që ka ndodhur pothuajse në çdo rast.
 - Në vitin 2022, hetimet proaktive kanë krijuar rezultate më frytdhënëse, kryesisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 283, 283/a, 284 dhe 298 të K.Penal. Si metoda speciale të hetimit, janë përdorur përgjimi, vëzhgimi në ambiente publike, veprimet simuluese.
- c) Në lidhje me raportet, analizat apo trajnimet e përbashkëta, të kryera në nivel vendor në kuadrin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2020, janë marrë këto masa:
 - Janë zhvilluar analiza dhe takime me shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, ku përveç problematikave të tjera, janë trajtuar edhe çështjet e hetimeve pasurore dhe të pastrimit të produkteve të veprës penale.
 - Prokurori i ngarkuar me raportimet periodike dhe drejtimin e çështjeve të kësaj natyre ka përzgjedhur tema trajnimesh që kanë të bëjnë me hetimin e këtyre lloj çështjeve dhe ka marrë pjesë rregullisht në trajnimet e kryera.
 - Në takimet ndërinstytucionale, fokusi ka qenë tek parandalimi i fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike, të dhëna këto që mund të shfrytëzohen edhe për hetimin e çështjeve të kësaj natyre. Takimet janë zhvilluar me përfaqësues të njësisë vendore, të prefekturës, të SHISH, të OSHEE, inspektoriatet e ndryshme, etj.
 - Marrja e informacionit nga institucione të tjera, për vitin 2022 ka rezultuar me një sërë rezultatesh të frytshme dhe ky bashkëpunim, duhet të shtrihet edhe në marrjen e informacionit, hetimin dhe zgjidhjen e çështjeve të kësaj natyre.
 - Lidhur me treguesit e çështjeve penale të hetuara për nenin 287 të K.Penal dhe të hetimeve pasurore, një sërë çështjesh janë në hetim e sipër, kurse një pjesë prej tyre janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushimin e tyre. Ndër problematikat e vërejtura për hetimin e këtyre çështjeve, përmendim: a) ngarkesa e lartë në punë e prokurorëve b) stafi i reduktuar i tyre për pjesën më të madhe të vitit c) filtrimi i informacionit dhe referimi i rasteve d) lëvizjet e shpeshta të oficerëve të shërbimeve e) caktimi dhe shpërblymimi i ekspertëve krijon kosto të larta.
 - Lidhur me krimet financiare, në veprimtarinë tonë janë ndeshur veprat penale të parashikuara nga nenet 171, 172, 173, 174, 178, 179, 179/a, 180, 181, 288, 288/a të K.Penal. Hetimi i këtyre veprave penale ka rezultuar i frytshëm dhe shumë çështje kanë përfunduar me dërgimin për gjykim të tyre.

- Të dhënat e hetimeve penale për nenin 287 të K.Penal dhe ato për hetimet pasurore si dhe të dhënat për krimet financiare për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, janë si më poshtë:
 Për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal janë regjistruar 12 proçedime penale të cilat janë në hetim.
 Për hetimet pasurore janë regjistruar 11 materiale për të cilat vazhdon verifikimi i pasurive.
 Për nenin 172 të K.Penal janë regjistruar 4 proçedime penale, nga të cilat një proçedim penal me dy të pandehur është dërguar për gjykim dhe tre proçedime penale janë në hetim.
 Për nenin 174 të K.Penal janë regjistruar 5 proçedime penale, nga të cilat dy proçedime penale me dy të pandehur janë dërguar për gjykim dhe tre proçedime penale janë në hetim.
 Për nenin 178 të K.Penal janë regjistruar 2 proçedime me dy persona nën hetim, aktualisht në fazë hetimi.
 Për nenin 179/a të K.Penal janë regjistruar 6 proçedime penale, katër janë dërguar për gjykim, dy në fazë hetimi.
 Për nenin 180 të K.Penal janë regjistruar 2 proçedime penale, nga të cilat një është dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Gjyrokastër me kërkesë për pushim dhe një proçedim penal është në hetim.
- d) Të dhënat për numrin e rasteve të hetuara për veprën penale të korrupsionit(aktiv e pasiv):
 - Janë në njetim dy raste për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i K.Penal.
 - Nuk ka asnjë rast për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i K.Penal.
 - Nuk ka hetime paralele për pastrim të produkteve të veprës penale për personat e proçeduar e dënuar për korrupsion, apo për krimet financiare.
 - Nuk ka pasuri të sekuestruara për këto hetime të kryera.
- e) Lidhur me zbatimin e Aktit të Koordinimit Institucional të datës 15.12.2020, lidhur me Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Poasçme:
 - Çështjet e referuara në Prokurorinë e Poasçme për veprën penale të korrupsionit për vitin 2022 dhe ato të ardhura nga kjo prokurori në Prokurorinë tonë:
 Nuk ka pasur rastë të kësaj natyre.
- f) Masat e marra për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr.17/2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale të dhunë ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe të udhëzimit të përgjithshëm nr.8/2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale të të miturve në konflikt me ligjin, viktimë dhe dëshmitarë”:
 - Si masa të marra së pari përmendim krijimin e mbështetjes për viktimat gra dhe të mitur, duke angazhuar asistencë psikologjike e sociale, me angazhimin edhe të koordinitorit të subjekteve të posaçëm.
 - Marrja e masave për neutralizimin e rrezikut të vazhdueshëm, duke caktuar masat e sigurimit të përshtatshme në rastet konkrete, me qëllim krijimin e mjedisit të sigurtë për viktimat e veprës penale.
 - Profilizimi e trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve të ngarkuar me hetimin e rasteve të tilla.
 - Përdorimi i alternativave të dënimit me burgim dhe dhënia e përparësisë risocializimit të të miturve në konflikt me ligjin.
 - Takime periodike me prokurorët për të diskutuar drejtimit e lartpërmendura dhe zbatimin e përmirësimit të tyre në të ardhmen.
 - Të dhëna për dhunën ndaj grave, dhunën në familje, viktimat të mitur, të mitur në konflikt me ligjin për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022, është si më poshtë:

- Per nenin 130/a të K.Penal janë regjistruar 25 proçedime penale, nga të cilat 12 proçedime penale me 12 të pandehur janë dërguar për gjykim ,për 2 proçedime penale është kërkuar pushimi i çështjes dhe 11 proçedime penale janë në hetim.

g) Të gjitha masat e marra nga ana e prokurorisë në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm për zbatimin e kërkesave të rezolutës së Kuvendit kanë patur ndikim në drejtimitet e mëposhtëme:

- Identifikimi i problematikave në veprimtarinë e prokurorisë.
- Fokusimi në grupin e veprave penale, ku është përcaktuar drejtimi prioritar, duke patur edhe bashkërendim dhe koordinim me Prokurorinë e Përgjithshme.
- Raportimi periodik si bazë studimore dhe krahasuese lidhur me përhapjen e veprave të caktuara penale.
- Fokusimi tek veprimtaria parandaluese e fenomeneve të caktuara, e koordinuar me një politikë penale realiste, duke marrë parasysh jo vetëm rëndësinë e faktit, por edhe tërësinë e kontekstit social dhe rrethanave personale të kryesve të veprave penale.
- Trajtimi i viktimave të veprave penale me kujdesin e duhur, duke u kujdesur që të mos riviktimizohen dhe rehabilitohen sa më lehtë.

Këto janë disa nga masat e marra në zbatim të kërkesave të rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e punës së prokurorisë për vitin 2021 dhe treguesit statistikorë të kërkuar nga ana juaj. Nga ana jonë nuk është përpiluar ndonjë plan veprimi i veçantë në zbatim të Planit të Veprimit të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Hartimi i një plani të tillë do të mbahet parasysh në vijimësi.

C) Masat e marra nga Drejtuesi i Prokurorisë për mbarëvajtjen e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër.

Në zbatim të detyrave të Drejtuesit të Prokurorisë për drejtimin, organizimin, bashkërendimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë në prokurori, kuadri ligjor i miratuar përbidhet në:

- Ligji nr. 97/2016 “ Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Kodi i Proçedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
- Urdhërat e Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.

Referuar këtij kuadri ligjor, veprimtaria e Drejtuesit të Prokurorisë, përbidhet në:

- a) Rolit të tij në zbatim të kompetencave që lidhen me veprimtarinë administrative;
- b) Ushtrimi i kompetencave proçeduriale penale.

Pavarësisht se me ndryshimet e reja në kuadër të Reformës në Drejtësi, është rritur pavarësia e prokurorit dhe organi i prokurorisë është konceptuar si i decentralizuar, ligjvënësi me dispozitat e përcaktuara në nenet 38, 42, 43, 46, 47, 48, 50 e vijues të ligjit nr. 97/2016 ka përcaktuar edhe kompetenca në normimin e veprimtarisë së punës në prokurori, duke patur parasysh:

- Krijimin e praktikave të qëndrueshme në trajtimin e rasteve të ngjashme.
- Përbushjen e detyrimeve ligjore të transparencës e llogaridhënies, pa cënuar pavarësinë e prokurorëve dhe efijencën në kryerjen e hetimeve.
- Forcimin e disiplinës në punë.
- Koordinimin, bashkërendimin dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mbështetëse e ndihmëse të veprimtarisë proçeduriale.

Për realizimin e këtij qëllimi, prokurori i përgjithshëm ka nxjerrë disa udhëzime të përgjithshme detyruese, me natyrë administrative, proçeduriale apo mikse, realizimi i objektivave të të cilave ka qenë një nga drejtimitet e normimit të veprimtarisë në prokurori.

- 1) Lidhur me zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12 datë 20.07.2020, ndryshuar me udhëzimin nr. 16 datë 14.12.2020.

Për qëllimin e normimit të mardhënieve të prokuror-drejtues në lidhje me trajtimin e çështjeve konkrete në prokurori, nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm është nxjerrë udhëzimi nr. 12 datë 20.07.2020(i ndryshuar me udhëzimin nr. 16 datë 14.12.2020). Ky udhëzim normon mënyrën se si drejtuesi i prokurorisë ushtron kompetencën për dhënien e udhëzimeve jo detyruese në çështjet konkrete, me qëllim që të ndikojë në drejtimet e sipërcituara dhe për të patur një organ akuze që “u tregon qytetarëve të njëjtën fytyrë”.

Hapat që ndiqen për realizimin e kompetencave të drejtuesit janë:

- Njoftimi i drejtuesit të prokurorisë nga zyra e regjistrimit për çdo vendim regjistrimi.
- Kërkesa e drejtuesit për informim për çështje konkrete.
- Informimi i detyrueshëm nga prokurori në çështje me masa sigurimi me privim lire, masa sekuestrimi pasuror dhe vendime përgjimi.
- Nxjerrja e udhëzimit jo detyrues nga drejtuesi i prokurorisë.
- Dhënia e shpjegimeve të tjera nga drejtuesi për udhëzimin jo detyrues.
- Informimi lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjeve në gjykatë.

Nga ana e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, janë kryer këto veprime për zbatimin e tij:

- Sigurimi i procesit të njohjes së prokurorëve dhe administratës me udhëzimin dhe diskutimi i vazhdueshëm për interpretimin e zbatimit e tij sa më të saktë në praktikë.
- Nxjerrja e urdhërit nr. 3 datë 04.09.2020 të drejtuesit të prokurorisë, me të cilin është urdhëruar krijimi i regjistrimit të komunikimeve të brendshme, caktimi i sekretares së ngarkuar me mbajtjen e tij si dhe njoftimi i prokurorëve për krijimin e regjistrimit.
- Trajnimi i brendshëm i sekretares së ngarkuar me mbajtjen e regjistrimit të komunikimeve të veçanta dhe shënimi nga ana e saj i komunikimeve drejtues-prokuror të kryera.

Gjatë vitit 2022, në regjistrin e komunikimeve të brendshme janë shënuar 164 raste të komunikimeve të brendshme, të cilat përfshijnë dhënien e informacionit të detyrueshëm drejtuesit lidhur me arrestimet në flagrancë dhe ndalimet.

Përgjithësisht, drejtuesi , për shkak të ngarkesës, e ka kërkuar informacionin verbalisht nga prokurorët dhe për vitin 2022 nuk janë dhënë udhëzime jodetyruese, por çështje të cilat kanë patur kompleksitet apo krijojnë ndjeshmëri dhe impakt social të konsiderueshëm, janë konsultuar me drejtuesin e prokurorisë.

Problematika që lidhen me zbatimin e udhëzimit:

- Ngarkesa e lartë në punë ndikon negativisht në zbatimin e udhëzimit.
- Zgjatja e gjykimit të çështjeve të caktuara, passjell mundësi për mospërditësim të informacionit.

Ndër masat e marra nga ana e drejtuesit të prokurorisë, kanë qenë:

- diskutimet me sekretaren e ngarkuar për mbajtjen e regjistrimit në mënyrë sa më korrekte dhe diskutimi me prokurorët për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky udhëzim.
- konsultimi me regjistrin e njoftimit të veprave penale nga drejtuesi, me qëllim evidentimin e çështjeve të cilat identifikojnë nevojën e komunikimeve me prokurorët para disponimit të çështjeve.
- njohja e drejtuesit me aktin e prokurorit me të cilin janë zgjidhur çështjet.

- 2) Lidhur me zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2019 , i ndryshuar/plotësuar me udhëzimin nr. 2/2021 datë 31.03.2021.

Në kuadër të mbarvajtjes së proceseve zgjedhore në Republikën e Shqipërisë dhe me qëllim zhvillimin me efikasitet të hetimeve dhe informimin në kohë sa më të shpejtë, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë në vitin 2019 udhëzimin me nr. 3 “Mbi masat administrative dhe

proceduriale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”.

Në zbatim të këtij udhëzimi, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë marrë këto masa administrative dhe proceduriale:

- Njohja dhe diskutimi me prokurorët për udhëzimin.
- Nxjerrja e urdhërit nr. 4 datë 26.06.2019 “Për marrjen e masave në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019”.
- Urdhëri nr. 1 datë 25.03.2021 për caktimin e grafikut të gadishmërisë për periudhën zgjedhore mars-prill 2021, duke dyfishuar gadishmërinë për periudhën në fjalë.
- Dhënia e informacionit periodik Prokurorit të Përgjithshëm nga prokurorja znj. Ermira Manelli, e caktuar për raportimin e krimeve në fushën e zgjedhjeve.
- Trajnimi i shërbimeve të policisë gjyqësore nga prokurori i caktuar, z. Emror Kasaj në vitin 2021.
- Për vitin 2022, diskutimi me prokurorët është fokusuar tek kuptimi teorik i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe evidentimi i mënyrës së veprimit për t’iu përgjigjur situatave në proceset e ardhshme elektorale.

3) Lidhur me udhëzimin e përgjithshëm nr. 3 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

Në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në udhëzimin e sipërcituar, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, shpërndarja e çështjeve është bërë nëpërmjet shortit elektronik. Për këtë qëllim janë caktuar sekretarja e regjistrimit dhe punonjësi IT për kryerjen e këtij procesi. Çështjet të cilat nuk i janë nënshtruar shortit elektronik janë:

- 1- Në rastet e çështjeve për të cilat prokurori i caktuar më parë është larguar nga kjo prokurori, të cilat janë shpërndarë nëpërmjet shortit manual, i dokumentuar me procesverbalet përkatës.
- 2- Çështjet që lidhen me ndërmarrjen e veprimeve të ngutshme nga prokurori, të cilat i janë caktuar prokurorit të gatshëm.
- 3- Çështjet me viktimë ose të dyshuar të mitur, të cilat i janë caktuar prokurorit për të mitur.
- 4- Çështjet për të cilat është hequr dorë nga prokurori i caktuar më parë nëpërmjet shortit elektronik.

Me urdhërin nr. 4 datë 10.05.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë, është urdhëruar të evidentohen të gjitha procedimet për të cilat ishte larguar prokurori i çështjes konkrete dhe pas evidentimit, caktimi i prokurorit për këto çështje, është bërë nëpërmjet shortimit manual.

Gjatë vitit 2022, përjashtimi i prokurorëve nga shorti është bërë për këto shkaqe:

- Për të siguruar një shpërndarje sa më të barabartë të çështjeve në prokurori.
- Për t’i dhënë mundësi objektive drejtuesit të ushtrojë kompetencat e veta.

Për vitin 2022, shorti elektronik është aplikuar gjithsej në 820 raste.

Për vitin 2022, përjashtime nga shorti elektronik i një prokurori me urdhër të drejtuesit është bërë në disa raste dhe qëllimi i përjashtimit ka qenë shpërndarja sa më e barabartë e ngarkesës mes prokurorëve dhe angazhimi në veprimtaritë administrative e ndihmëse të drejtuesit e prokurorëve. Në muajin gusht, për shkak të lejes vjetore të prokurorëve, me urdhërin nr. 2 datë 31.07.2022 të Drejtuesit të Prokurorisë, është urdhëruar shpërndarja e çështjeve të muajit gusht sipas grafikut të gadishmërisë.

4) Lidhur me udhëzimin e përgjithshëm nr.8/2020 , ndryshuar me udhëzimin nr. 6/2021.

Për përlogaritjen me saktësi të shpenzimeve procedurale, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë Udhëzimin e përgjithshëm nr. 8/2020, ndryshuar me udhëzimin nr. 6/2021. Në këtë udhëzim, përmenden aktet normuese të përlogaritjes së shpenzimeve përkatëse sipas veprimeve hetimore të kryera si dhe procedura që ndiqet për evidentimin e tyre.

Nga ana jonë, janë marrë këto masa për zbatimin e udhëzimit:

- Njohja e prokurorëve me përmbajtjen e udhëzimit dhe diskutimi i tij.
- Është respektuar masa e shpenzimeve procedurale sipas veprimeve përkatëse, të normuara me aktet përkatëse.
- Në rastet e ekspertimeve, është negociuar me ekspertët për përcaktimin e masës së shpërblimit nën vlerën referuese të normuar.
- Është ndjekur kriteri kronologjik në shlyerjen e shumave të shpenzimeve përkatëse.
- Është mbajtur regjistri i shpenzimeve procedurale, i cili dokumenton shpenzimet për veprime konkrete.

5) Lidhur me udhëzimin e përgjithshëm nr. 5/2020 datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”.

Lidhur me Udhëzimin nr. 5/2020 datë 13.05.2020 “Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës”, është bërë njohja dhe diskutimi i këtij udhëzimi me prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore duke rënë dakord që në çështje që kërkojnë verifikime komplekse dhe përcaktime e konkluzione shkencore të thelluara, të kërkohej konsultimi paraprak me shërbimin e ekspertizës. Nuk ka patur për vitin 2022 raste të konsultimit me këtë shërbim.

6) Lidhur me Udhëzimin nr. 10/2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”.

Janë marrë këto masa për zbatimin e udhëzimit:

- Njohja dhe diskutimi i udhëzimit nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore.
- Nga prokurori i përgjithshëm është organizuar një takim me drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, në muajin tetor të vitit 2022, takim i cili ka qenë i vlefshëm për kuptimin e drejtë të udhëzimit dhe zbatimin e tij në praktikë dhe monitorimin e kushteve të zbatimit të udhëzimit.
- Instalimi i sistemit elektronik “Statistika e veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurori”, duke dhënë akses për drejtuesin e prokurorisë dhe oficerët e policisë gjyqësore që do të përditësojnë të dhënat në këtë sistem.
- Nxjerrja nga Drejtuesi i Prokurorisë i Udhëzimit të përgjithshëm nr. 1 datë 19.12.2022 “Për mbikqyrjen e disiplinës së punonjësve të prokurorisë dhe marrjen e masave për ndjekjen e rasteve konkrete”.

Theksojmë se udhëzimi i përgjithshëm i nxjerrë nga ana e drejtuesit të prokurorisë ka patur për qëllim rritjen e disiplinës në punë dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së punonjësve të prokurorisë, unifikimin e procedurave të gjurmimit të shkeljeve disiplinore dhe evidentimin e dokumentimin e tyre, regjistrimin e procedurave në regjistrin përkatës të krijuar, krijimin e një komisionit të brendshëm verifikimin e shkeljeve. Në rastet kur shkeljet kryhen nga oficerët e policisë gjyqësore e prokurorët, rregullat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 10/2021 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkërendimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”, hyjnë në veprim dhe janë parashikuar edhe nga udhëzimi nr. 1 datë 19.12.2022 i drejtuesit të prokurorisë.

5) Masa të tjera të marra nga Drejtuesi i Prokurorisë

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 23, 24 dhe 138 të ligjit nr. 96 /2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në udhëzimin nr. 5 datë 30.07.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mardhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, bazuar edhe në Rregulloren e Brendshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër, është nxjerrë udhëzimi nr. 1 datë 19.05.2020 i Drejtuesit të Prokurorisë “Për rritjen në vazhdimësi të efektivitetit të kontrollit të disiplinës në punë”, ku disiplinohet mbajtja e plotësimi i listëprezencës, procedura e kërimit të lejeve të veçanta nga punonjësit, raportimi për respektimin e orarit zyrtar nga punonjësit si dhe rregullohet mënyra e komunikimit të punonjësve me qytetarët dhe mediat.

Nxjerrja e udhëzimit është bërë nisur nga situata e krijuar në atë kohë në prokurori dhe faktit që kërkesat verbale të personave të tretë në prokurori, krijonin pengesa për mbarvatjen e punës. Në këto kushte, u çmua se një nga aspektet e disiplinimit të punës dhe rritjes së efikasitetit, ishte e ndërlidhur edhe me mënyrën e komunikimit me qytetarët për dhënien e informacionit. Me këtë udhëzim është normuar mënyra e dhënies së informacionit e cila si rregull bëhet me shkrim, pas administrimit të kërkesës me shkrim të bëra nga pala e interesuar. Kjo mënyrë komunikimi ndiqet edhe për kërkimin e informacionit nga mediat.

Kjo mënyrë dhënie informacioni është ndjekur edhe për vitin 2022. Me vendimin nr. 1 datë 01.03.2020, është caktuar magjistrati i shtypit.

Me urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë, nr. 5 datë 10.07.2019, “Për caktimin e prokurorit dhe oficerit të policisë gjyqësore për çështjet me të mitur në konflikt me ligjin, të mitur viktimë dhe të rinj të moshës 18-21 vjeç”, është caktuar prokurori Emror Kasaj si prokuror për çështjet për të mitur. Duke qenë se ky prokuror figuron me statusin “i pezulluar”, pasi me vendimin nr. 529 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është disponuar me shkarkimin e tij, është nxjerrë urdhëri nr. 1 datë 17.05.2022 i Drejtuesit të Prokurorisë për caktimin e prokurores Ermira Manelli si prokurore që ndjek çështjet me të mitur.

Në zbatim të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 87 datë 28.07.2021 “Për miratimin e Rregullave për përdorimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, janë marrë këto masa:

- Është nxjerrë urdhëri nr. 2 datë 29.07.2021 i Drejtuesit të Prokurorisë, me të cilin urdhërohet përdorimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave për Çështjet me të Mitur dhe është caktuar punonjësi që do të ketë akses në këto të dhëna dhe që do të përpunojë ato.
- Janë hedhur dhe transmetuar të dhënat në sistem në mënyrë periodike, sipas përcaktimit të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në lidhje me çështjet për të miturit, rëndësi i është caktuar trajnimit vazhdues të prokurorit për të mitur, me qëllim ngritjen e vazhdueshme profesionale e profilizimin e mëtejshëm të tij. Për këtë qëllim, janë selektuar për t’u ndjekur ato trajnime që lidhen me këtë sferë të veprimtarisë nga ky prokuror.

Problematiche ngelet situata e ndryshimit të herëpashershëm të prokurorëve duke ngrikuar negativisht si në profilizimin e tyre ashtu edhe në mbarëvatjen e këtyre çështjeve penale.

Nisur nga ngarkesa e secilit prokuror, pasi janë emëruar dhe kanë filluar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër edhe prokuroret Blerina Musabelliu dhe Denisa Plaku, është bërë shpërndarje e çështjeve penale edhe për këto prokurore. Në muajin tetor 2022, është rënë dakord në mbledhjen e prokurorëve që çështjet me të mitur të ndiqen nga secili prokuror sipas shortimit elektronik apo gadishmërisë, deri në stabilizimin e organikës.

Ndër masat e marra në zbatim të Udhëzimit nr. 8/2021 datë 15.11.2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar”, përmendim:

- Njohja me udhëzimin dhe diskutimi i tij në mbledhje me prokurorët e oficerët e policisë gjyqësore.
- Përzgjedhja e trajnimeve me tema që lidhen me çështjet e administrimit të drejtësisë për të mitur përgjatë vitit 2022.
- Pjesëmarrja në trajtime e koordinatorit të subjekteve të posaçëm dhe e oficerëve të policisë gjyqësore.
- Marrja e kontakteve nga koordinatori i posaçëm me shoqata, organizata e njësitë e qeverisjes vendore, zhvillimi i takimeve dhe marrja e masave të integruara, me qëllim mbështetjen e të miturve.
- Bashkërendimi mes prokurorëve dhe koordinatorit të posaçëm në procesin e administrimit të drejtësisë.
- Raportimi periodik statistikor në Sistemin e Integruar të të Dhënave për të Mitur, në përputhje me urdhërin nr. 87/2021 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin, është mbajtur parasysh që si masat e sigurimit, ashtu edhe masat e dënimit të kërkuara ndaj tyre, të jenë përgjithësisht të buta, ku funksion parësor t'i jepet rehabilitimit të të miturit, mosndërpërjes së proceseve edukative, stimulimin e faktorëve pozitivë social, duke përzgjedhur ato masa që ndikojnë në ndërthurjen e shëndetshme të mardhënieve të mitur – komunitet. Vlen të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e këtyre çështjeve, zgjidhet me shmangie nga ndjekja penale. Gjithashtu, janë zbatuar edhe dënime alternative ndaj të miturve.

Rëndësi parësore i është kushtuar krijimit të një mirëqenieje psikologjike të të miturit, duke krijuar një ambient miqësor, duke kërkuar të identifikohen shkaqet kriminogjene në sjelljen e tij dhe duke u asistuar nga përfaqësues ligjore e psikologë. Po kështu, të miturit i është siguruar gjithmonë ndihma juridike dhe i janë respektuar të drejtat procedurale.

Lidhur me të miturit viktimë të veprave penale, rëndësi i është dhënë mosviktimizimit të tyre, duke shmangur sa të jetë e mundur ripyetjet, duke e larguar nga persona apo vende që ndikojnë negativisht në rikuprimin e pasojave apo bëhen premisë për ripërsëritje të veprave penale. Gjithashtu, marrja e kontaktit me operatorë që krijojnë mbështetje materiale, sociale, juridike dhe psikologjike për të miturit viktimë ka qenë një nga drejtimit e veprimtarisë sonë.

Në trajtimin e çështjeve me të mitur, një vëmendje e posaçme i është kushtuar ruajtjes dhe forcimit të mirëqënies emocionale të tyre. Në këtë drejtim, edhe me shërbimet e policisë gjyqësore, në takime të zhvilluara është mëshuar në ushtrimin e veprimtarisë hetimore në përputhje me këtë kërkesë. Kështu, zhvillimi i procedurave me të mitur dhe pyetja e tyre apo kryerja në veprimeve të tjera, zhvillohen në ambiente sa më miqësore.

Vlen të theksohet si problematikë fakti që ambientet ku zhvillohet procedura me të mitur, sin ë Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjyrokastër, ashtu edhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjyrokastër, nuk janë në lartësinë e kërkesave që dikton Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Kodi i Procedurës Penale dhe nevojiten shpenzime për përshtatjen e tyre.

Si problematikë tjetër veçojmë edhe qasjen që mediat vizive apo online kanë ndaj çështjeve me të mitur, duke mos respektuar kërkesat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur për mbrojtjen e privatësisë dhe duke ushtruar presion ndaj organeve proceduese për mënyrën e zgjidhjes së çështjeve.

Bazuar në ligjin nr. 9154 datë 06.11. 2003 “Për arkivat”, nenet 7, 8, 20 pika 4 e 5, 21, 42 dhe 43, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 888 “Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”, pika 6, 7, 9 dhe 12 pika “c” e “d” , në urdhërin nr. 4895/4 datë 01.11.2016 të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e formateve të listave tip të dokumentave gjyqësore që arkivohen nga gjykatat”, është nxjerrë vendimi nr. 1 datë 23.04.2021 i Drejtuesit

të Prokurorisë, “Për ngritjen e Komisionit të Ekspertizës për shqyrtimin e dokumentacionit administrativ dhe hetimor për ruajtjen, përpunimin, transferimin e destinimin e tyre brenda fondit arkivor”. Me këtë vendim është caktuar përbërja e Komisionit të Ekspertizës. Ndërkohë, me shkresën nr. 1519/21 prot datë 06.01.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme është vendosur në dispozicion lista tip me afatet e ruajtjes sipas llojit të dokumentacionit, e miratuar nga Komisioni i Ekspertizës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë vitit 2022 e në vazhdim, fondi arkivor është në përpunim e sipër, ndërkohë që është nxjerrë vendimi nr. 1 datë 13.09.2022, nëpërmjet të cilit është zvendësuar kryetari i Komisionit të Ekspertizës, prokurori Adnan Hoxha, me prokuroren Ermira Manelli, për shkak të transferimit të të parit në një prokurori tjetër. Po kështu, është zvendësuar antari i këtij komisioni Martin Pali, me punonjësen Erjona Taçi (koordinatore e posaçme). Janë listuar një pjesë e mirë e fondit arkivor, po punohet për krijimin e një indeksi të plotë elektronik dhe po vendosen afatet e ruajtjes së materialeve. Ky proces, duke qenë se zhvillohet për herë të parë, është shumë voluminoz dhe kërkon akoma kohë.

Në Prokurorinë Gjyrokastër janë evidentuar këto problematika lidhur me arkivimin e dokumentacionit:

- Ambientet e destinuara për arkivim të dokumentacionit nuk janë të mjaftueshme dhe janë shfrytëzuar për arkivim edhe hapësira të tjera në prokurori, duke krijuar vështirësi.
 - Indeksi i Arkivave është pjesërisht manual dhe nuk janë përfunduar indekset elektronike.
- Sekretarja e ngarkuar me administrimin e arkivës nuk e përballon dot e vetme këtë ngarkesë, duke qenë se kryen edhe detyra të tjera, por në vitin 2023 është shtuar një punonjëse me kontratë e cila po e asiston në trajtimin e materialeve arkivore.

Nga ana jonë, për trajtimin e këtyre problemeve, janë marrë këto masa dhe janë shpallur si objektiva për vitin 2023:

- Është mbajtur korrespondencë me Prokurorinë e Përgjithshme dhe është rënë dakord që ambientet e godinës së ish-Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tepelenë, të përshtaten për arkiv të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër.
- Është njoftuar Bashkia Tepelenë për ndërprerjen e kontratës së huapërdorjes së godinës së ish-Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tepelenë me shkresën nr. nr. 458/1 datë 06.12.2022 (që është finalizuar në 25.01.2023, datë kur objekti është marrë në dorëzim).
- Krijimi i infraskuturës në këtë objekt për përshtatjen dhe funksionimin si arkiv.
- Do të rakordohet me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për vlerësimin e vendimarrjes së afateve të ruajtjes së dokumentacionit dhe transferimin e një pjese të fondit arkivor në këtë arkiv, pas klasifikimit të ruajtjes së tij.

D) Analiza statistikore e veprimtarisë për vitin 2021

Në analizën e treguesve statistikorë për vitin 2022, do të zbatohet metodologjia përshkruese dhe ajo krahasuese për evidentimin e treguesve të kriminalitetit për këtë vit dhe për analizimin e veprimtarisë së prokurorisë. Zbatimi i këtyre metodologjive ka si synim që të nxjerrë në pah të dhënat statistikore, të specifikuar për të evidentuar tendencat e kriminalitetit, faktorët determinues të tij, identifikimin e metodave të procedimit nga organi i prokurorisë, veçanërisht procedurat e veçanta e të shpejta e masat e dënimit të caktuara. Në treguesit statistikorë vëmendja do të përqëndrohet edhe tek subjektet e posaçme, duke qenë se këto grupe diktojnë nevojën e trajtimit të veçantë të tyre.

Më pas analiza do të fokusohet edhe tek ngarkesa e punës për secilin prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore, me qëllim që të evidentohen këto faktorë objektivë që ndikojnë në punën e tyre dhe të hidhet një vështrim kritik për të bërë një ndarje sa më të drejtë të vëllimit të veprimtarisë.

1) Treguesit e përgjithshëm të veprimtarisë hetimore

Gjatë vitit 2022, në total janë administruar dhe trajtuar pranë kësaj prokurorie 473 materiale kallëzuese, nga të cilat për 454 materiale kallëzuese është disponuar me vendim mos fillimi i procedurës penale, kurse 19 materiale kallëzuese janë mbartur për vitin 2022. Për vitin 2022 janë regjistruar 600 procedime penale. Njëkohësisht janë mbartur 700 procedime penale nga vitet e tjera në vitin 2022. Gjithashtu është ushtruar përfaqësimi në gjykim, ekzekutimi i vendimeve penale dhe janë realizuar marrëdhënie juridiksionale me shtetet e huaja.

Zyra e Regjistrimit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës Gjyrokastër për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, ka evidentuar të regjistruara 600 (gjashtëqind) procedime penale me 163 persona nën hetim, 150 të pandehur, me 109 persona të hetuar me masë sigurimi “arrest në burg”, 39 persona me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, nuk ka asnjë person me masë sigurimi “arrest në burg” në mungesë, kurse 2 persona kanë qenë me masë sigurimi “shtrimi I përkohshëm në spital psikiatrik”, 1 person me masë sigurimi “ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në vende të caktuara”, 47 persona me pasën e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe 2 persona me masën e sigurimit personal “garanci pasurore”.

Janë mbartur për vitin 2022, gjithsej 700 procedime penale me gjithsej 118 persona nën hetim, 119 të pandehur, nga të cilët 44 prej tyre me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në total për vitin 2022 nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër janë hetuar 1300 procedime penale, me 281 persona nën hetim, 269 të pandehur, nga të cilët 153 hetuar me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në vitin 2022 ngarkesa ka qenë me e ulët se në vitin 2021, perkatesisht 60 procedime penale me e ulët. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i punës parandaluese dhe ndjekjes në vazhdimësi të veprimtarisë së paligjshme në fushën e kultivimit të trafikimit të bimëve narkotike, në parandalimin dhe goditjen e formave të trafikimit, si dhe reduktimit të veprave penale kundër personave apo pasurisë. Ka patur një situatë të përmirësuar të reduktimit të lartë të kultivimit të bimëve narkotike edhe në njësinë administrative të Tepelenës, ku më parë ky fenomen ka qenë shumë shqetësues. Puna e policisë ka qenë efektive duke parandaluar kultivimin dhe trafikimin e narkotikeve në një masë të konsiderueshme, megjithatë relievi i thyer dhe sipërfaqja e madhe e territorit, e kombinuar me personelin e reduktuar përbejnë një shqetësim që duhet trajtuar në të ardhmen. Ngarkesa e punës së prokurorëve ka qenë tepër e lartë, pasi sikurse u theksua ka patur mungesa në organike, numri i prokurorëve ka qenë i ulët dhe në ndryshim të herëpashershëm, çka ka sjellë zvarritje për shkaqe objektive të hetimit të çështjeve penale. Përveç kësaj, ndryshimet procedurale kanë sjellë situata kaotike me levizjen e dosjeve prokurori-gjykatë e anasjelltas, ku një pjesë të mirë të vonësave të zëveprimtarisë administrative e ngadaltë në adresimin e dosjeve konkrete.


Nga të dhënat krahasuese të përgjithshme mes dy viteve të fundit evidentohet:

GJATË VITIT 2021:

<u>Procedime</u>	<u>Mbartur</u>	<u>Gjykim</u>	<u>Pezullim</u>	<u>Pushime</u>	<u>Mosfillime</u>
660	687	220	171	49	514

GJATË VITIT 2022:

<u>Procedime</u>	<u>Mbartur</u>	<u>Gjykim</u>	<u>Pezullim</u>	<u>Pushime</u>	<u>Mosfillime</u>
600	700	264	141	146	454



Në një këndvështrim të përgjithshëm rezulton se për pjesën më të madhe të veprave penale më të përhapura në territorin e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka tendencë në rënie të numrit të tyre përgjatë vitit 2022, kurse për një grup më të vogël të veprave penale më të përhapura ka një tendencë në rritje të lehtë për vitin 2022. Arsytet e rritjes së numrit të veprave penale të konsumuara, do të analizohen më poshtë për secilin grup veprash. Në një vështrim të përgjithshëm rezulton se për veprat penale kundër pasurisë ka ulje të numrit të veprave penale të konsumuara. Për grup të caktuar veprash brenda një seksioni, evidentohen si rritja e numrit për disa vepra, ashtu edhe ulja e numrit për disa të tjera, si psh në fushën e narkotikëve.

- veprat penale më të përhapura janë në nivele më të ulta krahasuar me një vit më parë.
- veprat penale që hasen më shpesh janë ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, vjedhjet, prodhimi dhe shitja e narkotikëve, drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, kalimi i paligjshëm i kufirit, dhuna në familje.

- veprat që lidhen me narkotikët kanë tendencë ulje (kultivimi i narkotikëve dhe trafikimi i narkotikëve). Kultivimi i narkotikëve ka rënë nga 29 raste në vitin 2021, në 9 raste në vitin 2022, kurse trafikimi i narkotikëve, nga 7 raste në vitin 2021, ka rënë në 3 raste në vitin 2022. Ndërkohë që këto të dhëna në pamje të parë duken në kontrast me rritjen me dy çështje të numrit të veprës penale të prodhimit e shitjes së narkotikëve, ku nga 30 çështje që ishin në 2021, numri ka shkuar për këtë vit në 32 të tilla. Të analizuar këto shifra tregojnë se tendenca në ulje e kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, është tregues pozitiv i cili nga shërbimet e policisë gjyqësore është shoqëruar edhe me evidentimin e personave që mbajnë lëndë narkotike, çka ka bërë që të evidentohen shumë çështje penale ku personave përdorues u janë kapur doza të vogla

lëndësh narkotike. Pra kjo shifër ka ardhur si pasojë e rritjes së fuqisë evidentuese edhe e përdoruesve të lëndëve narkotike dhe e poseduesve të sasive të vogla të këtyre lëndëve. Të analizuara këto tregues së bashku me treguesin e trafikimit të lëndëve narkotike, rezulton se treguesit janë pozitivë, por shkalla e kosmumimit të lëndëve narkotike nga të rinjtë, është një fenomen shqetësues, për të cilin duhet qasje shumëplanëshe dhe nuk mjafton vetëm politika penale në kuptimin e ngushtë të saj.

- Për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, vihet re një rritje e rasteve të kryerjes së kësaj veprë penale, nga 22 raste në vitin 2021, në 25 raste në vitin 2022.

- Për veprën penale të “vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i K.penal, ka një ulje të rasteve nga 107 raste në vitin 2021, në 88 raste në vitin 2022, edhe ky një tregues pozitiv, por që ka vend akoma për përmirësim në kuadër të parandalimit të këtyre veprave penale. Për veprën penale të “shkatërrimit të pronës”, parashikuar nga neni 150 I K.penal dhe për veprën penale të “shkatërrimit të pronës me zjarr”, parashikuar nga neni 151 I K.Penal, vihet re një reduktim i ndjeshëm. Nga 22 çështje të regjistruara për veprën penale të “shkatërrimit të pronës” në vitin 2021, numri ka rënë në 3 çështje për vitin 2022, kurse për veprën penale të “shkatërrimit të pronës me zjarr”, nga 27 çështje në vitin 2021, ka rënë në 17 çështje në vitin 2022.

- Për veprën penale të “fallsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186 i K.Penal, ka një tendencë rritje, nga 10 raste në vitin 2021, në 15 raste në vitin 2022. Kjo tendencë në fakt ngelet për t’u analizuar, pasi rezulton se shumë çështje penale regjistrohen mbasi ka indicje në momentet e para për hetim, ose rezulton se gjykata mbi ankimin e personave urdhëron regjistrimin pas prishjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal. Megjithatë kryesisht fakti i referohet një kohë të shkuar, kryesisht për çështje që kanë lidhje me konfliktet e pronësisë.


- Për veprën penale të “ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i K.Penal ka një rënie të konsiderueshme të numrit të veprave penale, ku nga 20 çështje të regjistruara për vitin 2021, numri ka rënë në 8 çështje për vitin 2022.

- Vihet re tendencë në ulje për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, nga 17 raste në vitin 2021 në 13 raste në vitin 2022.

- Për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, vihet re një rritje e lehtë e numrit të çështjeve të kësaj veprë penale, nga 47 raste në vitin 2021 në 53 raste në vitin 2022. Vlen të theksohet se qasja me sanksione ndaj kësaj veprë penale ka konsistuar në qasjen dyfishe, e konkretisht kryesisht me caktimin e masave të sigurimit me arrest në shtëpi për autorët në gjendje të dehur dhe për personat përsëritës dhe në aplikimin e dënimeve plotësuese në raste të tilla. Po kështu, edhe masat e dënimit janë rritur në rastet kur ana objektive e kësaj veprë penale konsumohet në këtë mënyrë, duke aplikuar gjithsesi edhe dënimet alternative.

- ka tendencë në rritje për veprën penale: - “kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, (jane evidentuar 52 procedime për vitin 2022, kurse për vitin 2021 janë evidentuar 43 raste, pra 9 raste më shumë). Në analizën e bërë me shërbimet e policisë gjyqësore është rënë dakord që të shikohet mundësia e procedimeve administrativisht të personave që kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme. Ne pergjithesi shtetasit shqiptare, nuk shkojne ne vendet e bashkimit europian per turizem apo biznes , por per shkaqe ekonomike. Ata kerkojne te punesohen ne menyre afatgjate, duke shkelur ne kete menyre afatet e qendrimit ne zonen “Shengen”, c’ka detyrimisht i ngarkon me pergjegjesi administrative dhe i shnderron ne persona te padeshiruar dhe ne keto rrethana i kondicionon te kalojne kufirin ne menyre te paligjshme, ilegale, pasi rikthehen per te kerkuar pune ne vendet e Bashkimit European. Në masat e dënimit të caktuara nga ana jonë, janë marrë parasysh këto faktorë kriminogjenë.

- ka një tendencë dyfishimi për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i K. Penal. Nga 35 çështje penale të evidentuara në vitin 2021, në 76 çështje penale për vitin 2022. Kjo rritje është tregues i intensifikimit të lëvizjes së shtetasve të huaj transit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Shqetësuese përse i përket faktorëve kriminogjenë të brendshëm është predispozicioni i shtetasve të ndryshëm, kryesisht banorë të qyteteve të tjera për të marrë kontakt e dhënë ndihmë shtetasve të huaj nga vendet MENA(Middle East and North African). Vlen të theksohet se është rritur puna evidentuese e policisë së shtetit për këto raste, por fenomeni ngelet shqetësues. Në politikën penale të ndjekur nga ana jonë, qasja dyfishe, duke aplikuar masa sigurimi që janë në proporcion me faktin(që kërkon një vlerësim kontekstual), me sanksionet e dhëna, të cilat kanë marrë parasysh edhe rrethanat personale e familjare (mosha e re, papunësia, gjendja ekonomike, zhvillimi social) kanë përbërë një politikë të ndërthurur për reduktimin e fenomenit. Gjithsesi, edhe në këtë drejtim kërkohet një qasje shumëplanëshe, me qëllim që alternativat e veprimtarisë së paligjshme të mos shihen si mundësitë më të frytshme.




Më poshtë paraqitet përhapja e veprave penale në territor, të trajtuara gjatë vitit 2022, ku përfshihen çështjet e mosfilluara dhe ato të regjistruara, duke i krahasuar me vitin 2021, sipas grupimeve në Kodin Penal ku kemi veçuar:


- Kreu II Vepra penale kundër personit, krime kundër jetës (163 mosfillime viti 2021, kurse viti 2022 120 mosfillime, të regjistruara 65 viti 2021 dhe 47 viti 2022)




- Kreu III Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike (166 mosfillime viti 2021 dhe 132 mosfillime viti 2022, të regjistruara 291 proçedime për vitin 2021 dhe 197 për vitin 2022)




- Kreu IV Vepra penale kundër mjedisit(0 mosfillime për vitin 2021, 11 mosfillime për vitin 2022, 7 proçedime për vitin 2021 dhe 9 proçedime për vitin 2022)




- Kreu VIII Krime kundër autoritetit të shtetit(153 mosfillime për vitin 2021, 139 për vitin 2022, të regjistruara 281 për vitin 2021 dhe 326 për vitin 2022).



- Kreu IX Vepra penale kundër drejtësisë (20 mosfillime për vitin 2021, 13 mosfillime për vitin 2022, të regjistruara 11 për vitin 2021 dhe 19 për vitin 2022).




- Kreu X Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira (3 mosfillime për vitin 2021, 0 për vitin 2022, të regjistruara 5 procedime për vitin 2021, të regjistruara 0 për vitin 2022, duke qenë se nuk ka qenë vit kur janë mbajtur zgjedhje të përgjithshme apo lokale).



Për veprat penale të “pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale”, për vitin 2022 janë regjistruar gjithsej 12 raste, nga 7 raste që ishin regjistruar në vitin 2021.


Hetime pasurore për vitin 2022 janë regjistruar 11 raste, ndërkohë që në vitin 2021 janë regjistruar 36 të tilla. Për shkak të ngarkesës së lartë, nuk është bërë e mundur që këto procedime pasurore të përfundojnë në kohë.




Nga hetimet dhe vlerësimet konkrete në territorin që mbulon kjo Prokurori rezulton si me poshte:

- Vazhdon te jete e përhapur dhe aktuale vepra penale në fushën e narkotikëve, sidomos posedimi , ndërkohë që duhet të përmirësohet akoma më shumë situata me vjedhjet e pasurise, të reduktohet ndihma për kalim të paligjshëm te kufirit, kalim i paligjshem i kufirit, dhuna ne familje dhe krimet kundër personit.
- shkaqet e përhapjes së tyre janë të ndryshme:- sociale dhe ekonomike, probleme të infrastrukturës dhe edukimit të pamjaftueshëm në respektimin e rregullave e ligjeve, mosfunksionimi i rregullt i strukturave të ndryshme shtetërore që mbikqyrin veprimtari të palejuara dhe në shkelje të ligjit.
- ka tendencë në rritje, madje është teper shqetësuese dhe krijon ngarkesë fiktive fakti se kallzohet për raste që nuk lidhen me veprimtarinë e organeve të ndjekjes penale, pasqyruar kjo dhe në vendimet e shumta të mosfillimit te procedimit penal. Kjo vjen si rezultat i pasivitetit te administrates shteterore ne zgjidhjen e probleme dhe shqetesimeve te qytetareve.
- veprat penale dhe personat e hetuar e gjykuar kanë një shpërndarje të drejtë në raport me shpërndarjen e popullsisë, sipas numrit dhe territorit, por rezulton te kete me shume autore me banim ne qytet se ne fshat, 370 autore me banim ne qytet dhe 174 ne fshat, nga 312 autorë në qytet dhe 216 në fshat për vitin 2021.

- numri i të hetuarve meshkuj dominon dukshëm, pasi janë 537 persona meshkuj që janë marrë nën hetim, ndërsa 14 kanë qenë femra, nga 516 meshkuj dhe 12 femra për vitin 2021. Shtetas të huaj të proceduar, janë 19 të tillë për vitin 2022, nga 13 që ishin në vitin 2021. Po ashtu dominon numri i personave të papunë, kurse numri i personave përsëritës special janë 8 persona, ku tre janë për veprën penale të parashikuar nga neni 291, kurse nga 1 për veprat penale të parashikuara nga nenet 134, 283, 284, 298 dhe 323 të K.Penal. Numri i perseritesve për vepra të ndryshme është 38 në total, nga 41 që ka qenë vitin paraardhës.
- arrestimet në flagrancë në vitin 2022 janë 178 raste, ndërkohë që në vitin 2021 ishin 109 raste, pra janë në një masë më të lartë, ndalimet nga policia gjyqësore janë rritur këto vit, janë 10 raste, ndërkohë që për vitin 2021 ishin 5 raste. Nuk ka patur raste të urdhërimit nga prokurori të lirit të menjëhershëm të personit të arrestuar. Arrestimi në flagrancë i personave është bërë kryesisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 134, 283, 284, 290, 291 dhe 298 të K.Penal. Rritja e numrit të arrestimeve shpjegohet kryesisht me faktin e rritjes së numrit të veprave penale të “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit” ku në shumë çështje janë më shumë se një person i arrestuar dhe të veprës penale të “drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”.
- Kërkesat për caktimin e masave të sigurimit janë pranuar nga gjykata, janë 188 kërkesa, cfare ka sjelle si rezultat uljen ndjeshëm të apelimeve. Në vitin 2021 kanë qenë 114 kërkesa për caktim masash sigurimi. Kërkesa për caktim mase sigurimi arrest në burg nga 71 në vitin 2021, janë 100 në vitin 2022. Kërkesa për masën e sigurimit “arrest në shtëpi” për vitin 2021 kanë qenë 12 kërkesa, kurse për vitin 2022 janë 39 kërkesa. Për masën e sigurimit personal “detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, në vitin 2021 kanë qenë 30 raste, kurse në vitin 2022 janë 47 të tilla. Në vitin 2022 në dy raste është zbatuar masa e sigurimit personal “garanci pasurore”.
- Aplikimet e procedurave të reja kanë tregues pozitivë, si kërkesat në gjykatë, urdhërat penale, marrëveshjet etj.
- Nuk ka patur kallëzime penale për vitin 2022 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.
- Nga ana e Avokatit të Popullit në dy raste është kërkuar informacion për çështje konkrete, nga të cilat njëra çështje është përfunduar, kurse tjera vazhdon të jetë në fazën e hetimeve paraprake.






2) Treguesit e veprimtarisë për çështjet me të mitur

Për vitin 2022, janë 8 çështje me të mitur të regjistruara, nga të cilat në 6 raste të miturit janë të dyshuar si autorë të veprës penale, kurse në 2 raste janë në rolin e viktimës. Në vitin 2021, ishin gjithsej 17 çështje të regjistruara, nga të cilat në 7 raste i përkasin të miturve të dyshuar si autorë të veprave penale, kurse në 10 raste kanë qenë në rolin e viktimës së veprës penale shtetas të mitur. Për të miturit, në fazën e hetimeve ka patur një rast të caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, ndërsa në rastet e tjera ose të miturit janë ndjekur në gjendje të lirë ose masat e sigurimit kanë qenë të llojeve të tjera, pa privuar apo kufizuar lirinë personale të të miturve. Lidhur me zgjidhjen e çështjeve të të miturve dhe masat e dënimit, për autorët e mitur është aplikuar edhe shmangia nga ndjekja penale në 9 raste (megjithë çështjet e mbartura nga viti paraardhës, përfunduar gjatë vitit 2022) për nenet 89, 134 dhe 291 të K.Penal dhe për rastet e tjera janë dhënë dënime alternative.

Në rastet e të miturve viktimë të veprave penale, ndaj personave të dyshuar është zbatuar masë sigurimi ekstreme, ajo e arrestit në burg, në rastet e veprave me natyrë të ngacmimeve seksuale apo pornografi në tre raste. Në rastet e viktimave të mitur, Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Gjyrokastër ka ndjekur në varësi të rrethanave specifike dhe të faktit, ashpërsimin e dënimit me burgim.

Vëmendje në trajtimin e çështjeve me të mitur i është kushtuar bashkëpunimit me institucione të tjera që kanë në kompetencë trajtimin e të miturve, siç janë Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në njënitë vendore, zyrat e shërbimi social, shoqatat jofitimprurëse me objekt veprimtarie ndihmën e të miturve, Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës etj.



3) Një përshkrim analitik dhe krahasues i të dhënave statistikore dhe i faktorëve kriminogjenë

Në lidhje me strukturën e kriminalitetit dhe subjektet vërejmë:-

- raportet midis krimeve dhe kundërvajtjeve penale dominohen nga krimet.
- raportet për vendbanimin e subjekteve, qytet-fshat, tregojnë rritje të implikimit të banorëve të zonave urbane, megjithëse dihet se ka levizje demografike me tendence zhvendosjen drejt qyteteve dhe qendrave të rëndësishme urbane.
- në lidhje me gjininë e subjekteve është qartësisht evident dominimi i subjekteve meshkuj.
- midis subjekteve kemi patur dhe shtetas të huaj të cilët kanë kryer kryesisht veprën penale të “kalimit të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 297 i K.Penal, “ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298 i K.Penal dhe posedimi i lëndëve narkotike cannabis sativa në sasi të ulët, sipas nenit 283 të K.Penal.
- niveli i ulët arsimor i subjekteve është gjithashtu evident.
- vihet re ulja e kultivimit të narkotikëve dhe tendenca për uljen e vjedhjeve në zonat urbane dhe rurale.
- dukuri e vecantë mbetet tendenca e afrimit të kontigjentit kriminal nga jashtë territorit ku ushtrojmë kompetencën tokësore, kjo për shkak të kufirit të gjelbër me R.Greqise.
- mbetet shqetësues kategoria e përdoruesve të narkotikëve që kthehen lehtësisht në subjekte të veprave penale ndaj personit, dhunes në familje dhe vjedhjes së pasurisë dhe kuptohet dhe në fushën e narkotikëve.
- Ngelet shqetësues konsumimi i veprave penale nga subjekte të mitur, çka ka lidhje me demtimin e familjes si qeliza baze e shoqërisë, të sistemit arsimor dhe edukativ dhe indiferencës së pergjithëshme të shoqërisë.
- niveli i lartë i papunësisë dhe faktorët ekonomikë janë burim i rëndësishëm i një kategorie të gjerë krimesh dhe kundërvajtjesh.
- Faktorët kriminogjenë që ndikojnë në drejtim të llojshmërisë dhe numrit të veprave penale, mund të ndahen në dy grupe:

a) në faktorë objektivë që favorizojnë veprimtari të caktuar të paligjshme, ku përfshihen:

- sipërfaqja e madhe e territorit të rrethit gjyqësor Gjirokastrë dhe sidomos terreni i thyer dhe malor, që favorizon sidomos veprimtari në fushën e kultivimit të tregimit të narkotikëve.
- pozicioni gjeografik i territorit të rrethit gjyqësor Gjirokastrë, që duke qenë rreth kufitar, favorizon veprimtarinë e paligjshme në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike. kontrabandës së mallrave të personave (neni 298 i K.Penal) dhe kalimet e paligjshme të kufirit.

b) Në faktorë socialë, që ndikojnë në përfshirjen e personave të grupeve të ndryshme sociale në kryerjen e veprave të ndryshme penale:

- Niveli i ulët ekonomik i një pjese të madhe të popullsisë së këtij rrethi gjyqësor, ku shumë familje nuk plotësojnë dot nevojat bazike.
- Niveli i ulët arsimor i një pjese të konsiderueshme të popullsisë i lidhur me faktorin ekonomik dhe që ndikon në prespektivën e personave të paarsimuar të cilët në mungesë të kualifikimit të profilizimit në drejtime të caktuara, asocohen me shpejt me botën e krimit.

- Mungesa e urbanizimit të shumë qendrave të banimit rural, çka bën që mungesa e presionit të shëndetshëm social, t'ia lërë vendin krijimit të mangët të personalitetit individual.
- Mosintegrimi i komuniteteve të caktuara kulturore në shoqëri, si psh ai rom, etj, ku shoqëria duhet ta trajtojë këtë faktor si sfidë dhe jo të gjejë rrugën më të shkurtër.
- Mungesa e mardhënieve juridike të stabilizuara në çështjet e pronësisë, çka është bërë shkak për kryerjen e veprave penale të rënda në shumë raste.
- Migrimi i popullsisë brenda dhe nga jashtë rrethit gjyqësor, që ka çuar në uljen e nivelit homogjen të komuniteteve dhe për rrjedhojë thyerjen e stereotipit social të komunitetit.

Gjatë vitit 2022, ka reduktim të veprave penale të rënda kundër personit, ku në 1 rast kemi një vrasje të ngelur në tentativë, me pasoja në shëndetin e viktimës, krahasuar me 3 raste me humbje të jetës që ka qenë në vitin 2021. Ndër motivet kryesore të kryerjes së veprave penale të rënda, rezultojnë mosmarrveshjet që lindin në lidhje me mardhëniet e pronësisë si dhe në raste të tjera, konfliktet e mbartura në kohë, për motive të tjera, motive të dobëta, etj.

4) Faktorët që ndikojnë në hetimin e çështjeve penale

Në zgjidhjet përfundimtare të çështjeve kanë ndikuar:

- ulja e afatit për mosfillimet
- qëndrimi i përgjithshëm për vlerësimin më serioz të çështjeve
- rritja e pavarësisë së prokurorëve
- referimi i materialeve pa vlera juridike penale
- kallzimet formale të shtetasve
- rritja e nivelit të kallzimeve
- ndryshimet procedurale
- ngarkesa e punës për prokurorët e oficerët e policisë gjyqësore

Kryesisht çështjet janë pushuar “për mungesë fakti”, ketu përfshihen si rastet kur është konstatuar se fakti nuk ekziston, edhe ato kur fakti nuk përbën vepër penale si dhe për shkaqe të tjera. Çështjet e pushuara për mungesë të provave zënë një vend shumë të vogël në totalin e çështjeve të pushuara nga kjo prokurori, çka tregon për përpjekjet e bëra për të provuar akuzat në ngarkim të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekje penale, në rastet kur është provuar fakti penal, por jo përgjegjësia individuale (sipas pikës dh të nenit 328 të K.Pr.Penale). Rezulton te këto dhe çështje të pushuara “për shkaqe të tjera procedurale” ku vendin kryesor e zënë ato që kanë të bëjnë me heqjen dorë nga ankimi prej të dëmtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij.

Në vitin 2022 janë ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyrokaster, nga palët e interesuara vendime pushimi për kundravajtje dhe mosfillimi të procedimit penal, nga të cilat për rastet konkrete kanë rinisur hetimet. Konstatohet se në vazhdimësi Gjykata e Shkallës së Parë Gjyrokaster, me raste ka perkrahur kërkesat e paleve, duke shfuqizuar vendimet e mosfillimit apo ato të pushimit të arsyetuara nga prokurorët, qendrime të cilat janë perkrahur shpesh edhe nga Gjykata e Apelit. Për këtë arsye, nga ana e prokurorëve, vlerësimi i materialeve kallëzuese është pritur drejt regjistrimit të çështjeve penale, nisur nga praktikat e përcaktuara nga gjykata.

Gjatë vitit 2022 janë pezulluar 124 çështje penale, kundrejt 171 çështjeve të pezullura në vitin 2021. Mbetet shqetësuese problematika e vjedhjes së pasurisë dhe kultivimi i narkotikeve në drejtim të zbulueshmërisë së autorëve të veprave penale, megjithëse ka reduktim të këtyre veprave penale. Ato zënë përsëri vendin kryesor, ndërsa ka pezullime dhe për vepra të tjera. Vendimet e pezullimit janë marrë pasi janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore,

duke i kushtuar rëndësi të veçantë kryerjes së veprimeve në vendin e ngjarjes, fiksimit të provave në formën e parashikuar në ligj, etj. Ka qene dhe mbetet e detyrueshme ne baze te udhezimeve prania e prokurorit ne vendngjarjet me pasoja te renda si aksidente dhe vrasje. Për këtë qëllim ka patur komunikim të përhershëm me oficerët e Seksioneve dhe Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, si dhe drejtuesit e tyre për përmirësimin cilësor të kryerjes së veprimeve hetimore në fazën e hetimit paraprak.

Numri i procedimeve penale të pezulluara mbetet ende i lartë. Arrija e rezultateve kërkon një koordinim më të mirë të punës midis strukturave të policisë, por edhe ndërmjet prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore.

5) Treguesit e përfaqësimit në gjykatë dhe dënimeve

Për vitin 2022, janë dërguar gjithsej në total në gjykatë 247 çështje penale për gjykim të personave, krahasuar me 220 çështje të dërguara në vitin 2021. Është kërkuar pushimi për çështje penale në gjykatë për vitin 2022 në 98 raste, krahasuar me 154 raste në vitin 2021. Nga çështjet e dërguara për gjykim dhe që kanë përfunduar me gjykim të formës së prerë, zhvilluar me procedurë gjykimi të zakonshëm nuk ka raste në vitin 2022, kurse me gjykim të shkurtuar për vitin 2022, janë zhvilluar 28 raste. Këto të dhëna janë për çështjet e përfunduara me vendim të formës së prerë, çka do të thotë që jo se nuk ka gjykime të zhvilluara me procedurë të zakonshme për vitin 2022, por nga ato të përfunduara janë treguesit e mësipërm.

Me gjykim të drejtpërdrejtë janë dy raste në vitin 2022, ndërkohë që është 1 rast gjykimi i drejtpërdrejtë në vitin 2021.

Gjithashtu, për vitin 2022, rezultojnë të gjykuara me gjykime të poasçme:

- Marrëveshje fajësie 26 raste për vitin 2022, krahasuar me 27 raste për vitin 2021.
- Urdhëra penale 12 raste për vitin 2022, krahasuar me 16 raste për vitin 2021.


Për vitin 2022, janë pushuar me vendim të prokurorit 31 çështje penale, nga 49 çështje penale që janë pushuar në vitin 2021.

Në dënimet gjatë vitit 2022:

- ka patur një shpërndarje të drejtë, ku kanë nisur të dominojnë ato alternative, përkrahur në masë nga gjykata, vlerësuar dhe rast pas rasti për arritjen e qëllimit të dënimit.
- Dënimet me gjobë për vitin 2022 janë dhënë në 13 raste, nga 50 në vitin 2021.
- Dënimet me burgim për vitin 2022 janë 73 raste, nga 52 në vitin 2021.
- Neni 59 dhe 63 i K.Penal është zbatuar për 85 raste, krahasuar me 123 për vitin 2021. -janë kërkuar edhe dënime mesatare dhe në raste të veçanta drejt maksimumit të tij. -vazhdon të aplikohet gjatë këtij viti pezullimi i ekzekutimit dhe zëvendësimi i dënimit me punën në interes publik pa shperblim.

-janë aplikuar dhe masa dënimi me gjobë të përshtatshme, por mbetet problem shlyerja e tyre.

-ndryshimet e reja kanë ndikuar në mospasjen e një uniformiteti të politikës së dënimit, megjithëse janë bërë diskutime dhe analiza për unifikimin e qëndrimit të prokurorisë.



Gjate vitit 2022 Prokuroria e Gjirokastrës ka apeluar gjithsej 14 vendime themeli, nga të cilat 2 vendime themeli, për pafajësi.

Apelime themeli kundër masave të dënimit më të buta, janë gjithsej për vitin 2022, 10 raste, ku në 6 prej tyre, është përkrahur vendimi i prokurorisë.

Apelime kundër caktimit të masave të buta të sigurimit personal janë gjithsej në 32 raste, nga të cilat në 14 raste është përkrahur qëndrimi i prokurorit. Ka patur raste të apeleve kundërshtuese, në një rast kundërdrejtuar ankimit të personit të interesuar kundër vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes penale.

6) Veprimtaria në fushën e ekzekutimeve të vendimeve penale dhe mardhënieve juridiksionale me jashtë

Në fazën e ekzekutimeve të vendimeve penale, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, janë nxjerrë në total për vitin 2022, 171 urdhëra ekzekutimi, në krahasim me numrin prej 225 urdhëra që ishte në vitin 2021. Nga këto urdhëra ekzekutimi të nxjerra, disponimi ka qenë në 73 raste për ekzekutimin e dënimit me burgim, me gjobë në 13 raste dhe 85 për ekzekutimin e dënimeve alternative.

Për dënimet e caktuara me gjobë, problem ngelet shlyerja e dënimit me gjobë nga i dënuari, pasi pagimi i plotë i gjobës është bërë në vetëm një rast. Kryesisht gjobat kanë qenë të vendosura për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i K.Penal.

Lidhur me dënimet me burgim, si problem do të theksojmë faktin që dërgimi i vendimeve të formës së prerë, vonohet tej mase nga Gjykata e Apelit, pasi vendimet arsyetohen me vonesë dhe nuk dërgohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për shkak të ushtrimit të rekursit nga të dënuarit. Kjo ka bërë që në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë vendimi i formës së prerë të mos administrohet në kohë dhe për rrjedhojë urdhëri i ekzekutimit të mos dalë në kohën e duhur. Për rrjedhojë, i dënuari fizikisht vuan pa të drejtë dënimin në paraburgim, ndërkohë që llogaritja e bëhet sipas rregullave për dënimin. Për zgjidhjen e këtyre problemeve, i jemi drejtuar me shkresë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe kemi kërkuar vendosjen në kohë sa më të shpejtë të vendimeve dhe kjo situatë për vitin 2022 ka patur një farë përmirësimi.

Në lidhje me dënimet alternative, nuk janë vërejtur problematika në ekzekutimin e tyre dhe në vitin 2022 në asnjë rast nuk është kërkuar revokimi i tyre dhe zvendësimi me burgim. Për dënimet me punë në interes publik, bashkëpunimi me Zyrën e Shërbimit të Proves dhe njësitë e qeverisjes vendore ka qenë i frytshëm.

Në lidhje me mardhëniet juridiksionale me jashtë, për vitin 2022, ato konsistojnë në drejtim të përmbushjes së kërkesave për kryerje të veprimeve verifikuese e hetimore në shtete të tjera në funksion të çështjeve konkrete, në drejtim të përmbushjes së veprimeve të caktuara në

ekzekutim të kërkesave për ndihmë juridike të autoriteteve të huaja, si dhe veprime për ekzekutimin e urdhër arresteve ndërkombëtare dhe shpalljes në kërkim ndërkombëtar të personave nga autoritetet shqiptare. Gjithashtu, kryerja e procedurave për ekstradimin e personave jashtë shtetit dhe e procedurave për njohjen e vendimeve penale të huaja, janë drejtime bashkëpunimi që hyjnë në sferën e marrëdhënieve me autoritetet gjyqësore të huaja.

Për vitin 2022, u janë dërguar gjithsej autoriteteve të shteteve të huaja 20 kërkesa për ndihmë juridike, për kryerjen e veprimeve hetimore në çështje konkrete.

Ndërkohë, për vitin 2022, janë kryer veprime për ekzekutimin e 2 kërkesave për ndihmë juridike të ardhura nga autoritetet gjyqësore të huaja, nga të cilat në njërin prej tyre janë kryer një sërë veprimesh hetimore, në prani të përfaqësuesve të autoriteteve belge të drejtësisë.

Janë nxjerrë urdhra kërkimi ndërkombëtar për 10 persona, nga të cilët 6 urdhëra janë nxjerrë për vendime dënimi, kurse 4 të tjerë për ekzekutim masash sigurimi “arrest në burg”.

Ka patur një kërkesë për ekstradim nga autoritetet e huaja për vitin 2022 dhe më pas për të njëjtin rast është bërë kërkesë për njohje vendimi penal të huaj, kërkesë e cila është përfunduar së gjykuari në gjykatën e shkallës së parë dhe është mbartur e ankimuar nga organi i prokurorisë për vitin 2023.

Nuk ka patur kërkesa nga ana jonë për transferim procedimi autoriteteve të huaja dhe as nga autoritete të huaja në drejtim të prokurorisë sonë.

7) Të dhëna për treguesit e punës për secilin prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore të seksionit

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjirokastrë, për vitin 2022 kanë ushtruar funksionin e prokurorit:

- Julian Çafka – Drejtues i Prokurorisë, i caktuar përkohësisht.
- Emror Kasaj – nga data 01.01.2022 – 09.05.2022(pezulluar pas vendimit të KPK)
- Ermira Manelli - prokurore
- Denisa Plaku – prokurore (në detyrë prej 27.07.2022 e në vazhdim).
- Blerina Musabelliu (në detyrë prej 27.07.2022 e në vazhdim).

Vlen të theksohet se në strukturën e miratuar nga Prokuroria e Pergjithshme , të dërguar me shkrresë nr.127/15, date 31.01.2022, parashikohet të ushtrojnë veprimtari në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë 7 prokurorë, duke përfshirë drejtuesin dhe zvendësdrejtuesin e prokurorisë. Nisur nga mungesa e numrit të prokurorëve në organikë për pjesën më të madhe të vitit dhe mosplotësimi i saj, volumi i punës për prokuror, ka qenë tepër i lartë, duke ndikuar në afatet e hetimeve dhe në mbartjen e shumë çështjeve penale.

Po pasqyrojmë në tabelën e mëposhtme të dhënat analitike me çështjet e trajtuara dhe të mbartura për secilin prokuror.

VITI 2021

Prokurori	Çështje	Dërguarnëgjyq	Pushuar	KerkesePush.	Pezulluar	Shpallurmoskompetenca	K.M.M.Fajesie	K.M.U.Penal	Mosfillime	Mbartur
Julian Çafka	411	35	09	42	49	09	10	02	90	255
Emror Kasaj	479	52	09	33	19	05	07	06	144	348
Ermira Manelli	327	62	17	43	67	07	13	05	160	113
Adnan Hoxha	130	28	14	36	36	02	06	08	136	-

VITI 2022

Prokurori	Çështje	Dërguarnëgjyq	Pushuar	KerkesePush.	Pezulluar	Shpallurmoskompetenca	K.M.M.Fajesie	K.M.U.Penal	Mosfillime	Mbartur
Julian Çafka	416	62	15	62	47	05	11	4	146	210
Emror Kasaj	53	25	02	08	05	-	07	06	51	-
Ermira Manelli	375	100	12	28	51	03	07	05	167	169
Denisa Plaku	229	17	01	03	10	-	04	-	43	194
Blerina Musabelliu	227	16	02	13	28	04	-	-	47	164

Prokurori i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale, nga data 01.01.2022- 30.10.2022, ka qenë prokurori Julian Çafka, kurse prej kësaj date e në vazhdim, prokuror i caktuar me ekzekutimin e vendimeve penale, është prokurorja Blerina Musabelliu. Veprimtaria në këtë drejtim konsiston në nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit dhe dërgimin e tyre organeve përkatëse si dhe përfaqësimin në gjykim të kërkesave që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.

Ngarkesa e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, ka qenë relativisht e lartë. Po përshkruajmë ngarkesën për secilin oficer të policisë gjyqësore:

Martin Pali, për vitin 2022 ka hetuar gjithsej 9(nëntë) proçedime penale, me 3 persona nën hetim, në gjendje të lirë. Nga këto proçedime penale, për 3 proçedime penale është rekomanduar pushimi i çështjes, kurse 6 proçedimet e tjera janë mbartur për vitin 2023.

Çlirim Puto për vitin 2022 ka hetuar gjithsej 153 procedime penale, prej të cilave 102 kanë përfunduar, ndërsa 51 janë mbartur për vitin 2023, me 64 persona nën hetim, prej të cilëve 8 me masë sigurimi “Arrest në burg”. Nga 102 procedimet penale të përfunduara gjatë vitit 2022, për 25 procedime penale është rekomanduar pushimi i çështjes, për 10 procedime penale është rekomanduar pezullimi dhe për 61 procedime penale është rekomanduar dërgimi për gjykim me 64 të pandehur.

Drini Pasho për vitin 2022 ka hetuar gjithsej 125 procedime penale, prej të cilave 95 kanë përfunduar, ndërsa 30 janë mbartur për vitin 2023, me 63 persona nën hetim, prej të cilëve 10 me masë sigurimi “Arrest në burg”. Nga 95 procedimet penale të përfunduara gjatë vitit 2022, për 23 procedime penale është rekomanduar pushimi i çështjes, për 9 procedime penale është rekomanduar pezullimi dhe për 63 procedime penale është rekomanduar dërgimi për gjykim me 63 të pandehur.

Artur Boni (korrik-dhjetor) për vitin 2022 ka hetuar gjithsej 39 proçedime penale, nga të cilat 27 kanë përfunduar dhe 12 proçedime penale mbarten për vitin 2023. Nga këto, për pesë proçedime penale janë hetuar me persona me masë sigurimi “arrest në burg”. Për 5 proçedime penale është sygjeruar pushimi i çështjes penale, për 2 proçedime penale është rekomanduar pezullimi i hetimeve dhe për 20 prej tyre është rekomanduar dërgimi për gjykim, me 21 të pandehur.

Erlin Lani, emëruar në Shtator të vitit 2022, ka hetuar gjithsej 93 dosje hetimore, nga të cilat të përfunduara brenda vitit 2022, 44 procedime penale, me 47 persona nën hetim, nga të cilët 10 prej tyre me masën e sigurisë “arrest në burg”. Nga këto procedime penale, për 31 prej tyre i është rekomanduar prokurorit “dërgimi për gjykim”, për 9 procedime është rekomanduar “pushimi i çështjes”, nga të cilat për 6 procedime me të mitur është rekomanduar aplikimi i masës së “shmangies nga ndjekja penale” sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Për 3 procedime penale është rekomanduar aplikimi i “urdhrit penal” dhe për 4 procedime “pezullimi” i hetimeve.

Vlen të theksohet se oficeri i policisë gjyqësore Martin Pali, është angazhuar në detyra të tjera e konkretisht:

- Në shkëmbimin e korrespondencës me institucionet e tjera, në çështje për verifikimin e personalitetit të shtetasve.
- Në shkëmbimin e korrespondencës për proçesin e vetingut.
- Në përpilimin e akteve të fazës së ekzekutimit të vendimeve penale, duke asistuar prokurorin e ekzekutimeve.
- Në asistimin e prokurorëve për përpilimin e kërkesave për pushim të çështjeve penale të pezulluara më parë për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit të ndjekjes penale.

- Në mbajtjen dhe raportimin e statistikave në mënyrë periodike çdo tre muaj dhe vjetore. Për shkak të përmbushjes edhe të këtyre detyrave, oficeri i policisë gjyqësore Martin Pali është caktuar me më pak çështje penale për t'i hetuar.

E) Çështje të tjera

Në çështjet e tjera për t'u raportuar, do të ndalemi tek veprimtaria e magjistratit të medias, tek veprimtaria e koordinatorit të subjekteve të posaçëm dhe tek të dhënat në lidhje me zërat e shpenzimeve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër .

1) Veprimtaria e prokurorit që kujdeset për mardhëniet me publikun dhe median. Mbështetur në nenet 38, pika 2, gërma “e” , 42 gërma “j” dhe 61, pika 2 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, është caktuar me vendimin nr. 1 datë 01.03.2020, prokurori që kujdeset për mardhëniet me publikun e mediat në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër. Kjo detyrë i është ngarkuar prokurores Ermira Manelli. Po kështu, si koordinator për mardhëniet me publikun është caktuar oficeri i policisë gjyqësore Martin Pali.

Veprimtaria e prokurorit të caktuar për mardhëniet me mediat e publikun, është orientuar në këto drejtime:

- Për normimin e procedurës së kërkimit dhe dhënies në informacionit.
- Për bërjen e transparencës së detyrueshme për publikun nëpërmjet afishimeve të informacionit.
- Në dhënien e informacionit për publikun në raste të caktuara.
- Në bashkëpunimin me Prokurorinë e Përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave.

Ndër veprimet e kryera nga prokurorja Ermira Manelli, për përmbushjen e kësaj detyre, përmendim:

- Dhënia e informacionit për mediat për çështje të caktuara, pa cënuar veprimtarinë hetimore.
- Kërkesa për kryerjen e afishimeve përkatëse dhe afishimi i informacionit të detyrueshëm për njohje të publikut.
- Përmbajtja e informacionit është konceptuar dhe redaktuar nga koordinatori për mardhëniet me publikun, z. Martin Pali.

2) Veprimtaria e koordinatorit të subjekteve të posaçëm

Në bazë të nenit 80 të ligjit nr. 97 /2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 1 datë 12.06.2019, pas zhvillimit të procedurave, është emëruar në funksionin e koordinatorit të subjekteve të posaçëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër, znj. Erjona Taçi.

Ndër drejtimet e veprimtarisë që ajo ka kryer qysh nga koha e emërimit të saj në këtë detyrë, po përmendim:

- Pjesmarrja në trajnime me qëllim rritjen e përgatitjes profesionale në lidhje me pozicionin e saj të punës.
- Zhvillimi i takimeve të punës me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Shoqatat që zhvillojnë programe për mbrojtjen e personave të mitur dhe viktimave të trafikimit, me qëllim ardhjen në ndihmë shumëplanëshe këtyre kategorive personash.

- Mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm me zyrat e shërbimit social, me qendrat e strehimit të viktimave, me shoqata jo qeveritare dhe me Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, për t'iu përgjigjur situatave konkrete.
- Mbajtja e kontakteve me ekspertë psikologë, me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, me mbrojtës të trajnuar për çështjet me të mitur.
- Mbajtja e kontakteve me shërbimet e policisë gjyqësore të Komisariateve përkatëse për njoftimin e rasteve që kërkojnë asistencë juridike, psikologjike dhe materiale.

Si rezultat i veprimtarisë së zhvilluar, rastet me të mitur të dyshuar apo viktimë, me viktimë femra dhe persona të pazotë për t'u mbrojtur janë trajtuar përtej përcaktimeve të thata procedurale, por në bashkëpunim me policinë gjyqësore, janë marrë masa në këto drejtime për këto subjekte:

- Për normalizimin e mirëqënies psiko-emocionale të subjekteve të posaçëm.
- Për sigurimin afatshkurtër e afatmesëm të kushteve minimale materiale të jetesës, si strehim, ushqim dhe veshmbathje.
- Për sigurimin e ndihmës me asistencë të vazhdueshme psikologjike, sociale dhe juridike.
- Për evidentimin e faktorëve që kanë ndikuar në ardhjen e pasojave, si familja, shkolla, shoqëria dhe marrja e masave për korrigjimin e shkaqeve.

3) Fondet monetare në dispozicion dhe shpenzimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër për vitin 2022 ka patur fonde buxhetore faktike në shumën totale 50145243 të realizuara këto në ndarjen e Artikujve si më poshtë :

600 "Paga të personelit të përhershëm" në shumën 33 732 612

601 "Kontribute të sigurimeve shoqërore" në shumën 4 316 510

602 "Mallra e shërbime" në shumën 11 836 121

Detyrimet për këtë vit janë në vlerën 1334124 leke ku pjesën më të madhe e zënë detyrimet për shpenzimet për honoraret ku përfshihen shpenzimet për avokat, ekspert të ndryshëm, përkatësit, shërbime kadastrale, për këtë të fundit detyrimi është me tepër evidentim shpenzimi.

Në lidhje me furnizimin dhe harxhimin e karburantit për këtë vit janë harxhuar 1800 litra mesatarisht nga 150 litra në muaj për një autoveturë tip "Scoda Octavia".

Struktura organike në këtë prokurori ka funksionuar sipas strukture së dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresë nr.127/15, datë 31.01.2022. Ndërsa për periudhën në vazhdim ndryshimet gjatë vitit, shtesat ose pakesimet janë bërë me urdher të Prokurorit të Përgjithshëm, në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"

Në lidhje me ambientet e institucionit kemi në përdorim katin e tretë të Gjykasës së Shkallës së Parë Gjyrokastër konkretisht janë 10 zyra nga personeli dhe një zyrë përdoret për për arshiven e Prokurorisë e cila nuk i përmbush nevojat dhe funksionin e arshives (e pamjaftueshme hapësira). Gjithashtu nuk kemi një ambient të përshtatshëm për mbajtjen e provave materiale.

F) Grupimi i problematikave dhe masat që duhen marrë për vitin 2022 e në vazhdim për eliminimin e tyre.

Në këtë rubrikë, po përshkruajmë problemet që janë vënë re në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe në veprimtarinë e policisë gjyqësore:

1) Problematika në veprimtarinë e policisë gjyqësore

- Lëvizjet e shpeshta të oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë, kanë sjellë që çështje të caktuara të ndërrohet disa herë oficeri i policisë gjyqësore dhe hetimet të zvarriten. Pë këtë qëllim, në diskutim me drejtuesit e policisë gjyqësore është rënë dakord që në rast lëvizje të oficerëve të policisë gjyqësore brenda kësaj drejtorie, dosjet të vazhdojnë të hetohen nga të njëjtët oficerë të caktuar në urdhërin e delegimit të veprimeve hetimore.
- Lëvizjet e shpeshta të oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve sjellin për pasojë mosambientimin e mungesën e profilizimit në drejtimin që ata duhet të ndjekin, e për pasojë, e ulin efikasitetin në punë.
- Ligji nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, nuk po gjen zbatim, qoftë me krijimin e strukturës së posaçme hetimore, qoftë me dhënien e pëlqimit nga Komisioni i Policisë Gjyqësore për transferimin e oficerëve të policisë gjyqësore.
- Oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të policisë gjyqësore janë të mbingarkuar me veprimtari administrative, çka ndikon drejtpërdrejt në rendimentin e veprimtarisë procedurale të tyre.
- Vihet re që për çfarëdo faktesh të ndodhura, njoftohen shërbimet e policisë gjyqësore, të cilat kryejnë veprime procedurale edhe në rastet kur fakti duhet të verifikohet nga inspektoriate të ndryshme si INUV, AKU, Inspektoriat i Mjedisit dhe Pyjeve, etj. Lidhur me këtë problematikë, është diskutuar me drejtuesit e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe është rënë dakord që përveç zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit, në raste të caktuara të njoftohen edhe inspektoriatet përkatëse për të zbatuar detyrat e tyre. Marrja e kësaj mase duhet bërë pasi ka ndodhur që për kundravajtje administrative prokurori vendos mosfillimin e procedimit penal, ndërkohë që punonjësit e inspektoriatit përkatës e quajnë rastin të zgjidhur me referimin e faktit në prokurori. Për evitimin e kësaj problematike, kemi rënë dakord që inspektoriatit të nisë praktikë paralele, me qëllim që të rakordohet për përgjegjësinë në rastet konkrete, pa cënuar parimin e mosndërshkimit dy herë për të njëjtin fakt.
- Relievi i thyer e malor dhe mungesa e rrugëve automobilistike ndikojnë në shpejtësinë e konstatimit dhe të kryerjes së veprimeve verifikuese në raste të caktuara, sidomos për rastet e verifikimit për bimë narkotike të kultivuara apo për kontrabandën e personave e mallrave.
- Ndarja e punës nga shërbimet e policisë gjyqësore duhet bërë duke marrë parasysh që oficerët e rinj dhe pa përvojë të policisë gjyqësore, të asistohen në të njëjtin drejtim veprash nga një oficer më me përvojë, me qëllim mbështetjen e të parëve dhe ecjen e tyre në drejtim të ngritjes profesionale në mënyrë të qëndrueshme.
- Shpesh vihet re që veprimet hetimore të kryera në çështje konkrete nuk kryhen në mënyrë koherente, por të shpëputura, çka ndikon në provueshmërinë e fakteve. Nga ana jonë është vendosur theksi se veprimet e ngutshme hetimore duhet të kryhen të plota, duke pyetur edhe të gjithë dëshmitarët, pasi me kalimin e kohës qëndrimi i tyre mund të ndikohet. Arsyet e ndikimit në qëndrimin e dëshmitarëve mund të jenë nga më të ndryshmet, si psh, ai familjarizohet me faktin e ndodhur dhe ngjarja nuk ushtron më

trysni në psikikën e tij, pozicionohet dhe mban qëndrim oportun, frikësohet, manipulohet, etj. Po kështu, prova reale të caktuara mund të manipulohen nga personat e interesuar. Prandaj, në analizat e zhvilluara me oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve dhe drejtuesit e tyre, theksi është vendosur në kryerjen jo vetëm me koherencë të veprimeve hetimore, por edhe në shterimin në momentet e para të të gjitha veprimeve që mund të kryhen deri në referimin e faktit në prokurori, duke njoftuar paraprakisht edhe prokurorin.

- Një nga problemet e tjera që është konstatuar është edhe çështja e bashkëpunimit të publikut në zbardhjen e fakteve në çështjet penale. Vihet re se qytetarët zakonisht janë indiferentë dhe jo bashkëpunues për të raportuar apo ndihmuar në faktet për të cilat vijnë në dijeni. Kjo vjen për dy arsye kryesore. Së pari, ata nuk e konsiderojnë shtetin si partnerin kryesor në veprimtarinë e tyre jetësore. Së dyti, qytetarët mendojnë se futen në një kalvar thirrjesh nga organet e sistemit të drejtësisë kur kallëzojnë fakte, të cilat i pengojnë në punën e veprimtarinë e tyre të përditshme. Për shërbimet e policisë gjyqësore lind domosdoshmëri që të forcohet më tej imazhi i veprimtarisë së tyre me qëllim që komuniteti tek ata të shohë pasqyrën e vetes së vet ku mund të besohet siguria e tyre publike.
- Një nga problemet e vërejtura në veprimtarinë e shërbimeve të policisë gjyqësore, është edhe referimi për fakte që cilësohen sipas nenit 287 të K.Penal apo për hetime pasurore, në kushtet kur ngjarjet që lidhen me veprën mëmë prej kohësh e kanë humbur aktualitetin dhe ku duket e pamundur që të bëhet lidhja llogjike që mes veprës mëmë dhe pasurive aktuale të subjektit, në kushtet e ndërprerjes së veprimtarisë kriminale apo mungesës së indicjeve për krijimin e të ardhurave nga vepra mëmë. Në këto kushte për policinë gjyqësore, edhe në analizat e bëra, kemi mëshuar në: a) referimin e rasteve duke patur parasysh veprimtari aktuale kriminale dhe përdorim të personave apo shoqërive koperturë b) mëshimin në hetimet paralele, duke hetuar edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, në rastet e veprave penale që krijojnë të ardhura c) përdorim i metodave speciale të hetimit d) shfrytëzimi i aksesit në databazet shtetërore e) shtritja e hetimit edhe në vende të tjera dhe në persona të tjerë f) të qenit dyshues në rastet e ndryshimit të papritur të gjendjes pasurore të personave, të mënyrës së jetesës apo mosjustifikueshmërisë së pasurive të përdorura nga shtetas.
- Hetimet proaktive të filluara nuk kanë qenë të frytshme deri në vitin 2021, megjithatë për vitin 2022 treguesit janë përmirësuar me disa raste të suksesshëm, për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a, 298 dhe 174. Suksesi i është dedikuar cilësisë së informacionit dhe integritetit të personave të angazhuar në verifikimin e tij. Është rritur zbatimi i metodave speciale të hetimit dhe nuk është përqëndruar ky hetim vetëm tek përgjimi dhe vëzhgimi në vende publike, por edhe me vendosjen e pasjisjeve gjurmuese. Megjithatë objektiv për të ardhmen ngelen përdorimi i më shumë metodave speciale të hetimit, si blerja e simuluar, dorëzimi i kontrolluar, infiltrimi, etj. Lind si domosdoshmëri që qysh në referimin e veprës penale, oficeri i policisë gjyqësore të ketë një vizion të qartë për rrugën që duhet të ndjekë hetimi dhe prespektivën e tij.
- Duhet të rritet veprimtaria parandaluese, duke përdorur mjete të informimit, të komunikimit, të bashkëpunimit me njësitë vendore e pushtetin lokal, si pjesë të programeve të policimit në komunitet.

Të gjitha këto mangësi, në i kemi shprehur e diskutuar me drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjrokastër dhe kemi gjetur mirëkuptimin e tyre për minimizimin e tyre në të ardhmen.

2) Problematika në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër.

- Së pari, si mangësi për vitin 2022 theksohet personeli i reduktuar dhe në ndryshim të vazhdueshëm deri në mesin e vitit 2022 dhe ambientet e pamjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë. U bënë vite që në këtë prokurori organika nuk ka qenë e plotë, ndërkohë që situata është përmirësuar nga muaji gusht e në vazhdim, me emërimin në prokurori të dy prokuroreve dhe të dy oficerëve të policisë gjyqësore. Proçesi i vetingut ka ndikuar me shkarkimin e tre prokurorëve dhe reduktimin e numrit të përgjithshëm të prokurorëve në shkallë vendi. Ambientet e prokurorisë rezultojnë të pamjaftueshme, pasi në disa zyra janë vendosur nga dy oficerë të policisë gjyqësore dhe në rast plotësimi të organikës, kjo do të ndodhë edhe me prokurorët, ndërkohë që zyrat kanë hapësirë të vogël. Po kështu, kemi theksuar se vështirësi ka krijuar mbajtja e arkivës së dokumentacionit dhe të provave materiale, pasi këto ambiente janë tejmbushur dhe administrimi i tyre po bëhet edhe nëpër zyra. Në këto kushte, kemi kërkuar të ndërpresim kontratën e huapëdorjes me Bashkinë Tepelenë për objektin e ish-Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tepelenë dhe përshtatjen e ambienteve të këtij objekti për arkivim e akteve.
- Lëvizjet e shpeshta të numrit të prokurorëve kanë bërë që shumë çështje të zvarriten, të kalojnë në disa duar prokurorësh deri sa të marrin zgjidhje në një afat relativisht të gjatë.
- Ngarkesa e lartë në punë e prokurorëve ndikon drejtpërdrejt në shpejtësinë e hetimeve dhe në cilësinë e tyre, por kjo situatë ka ardhur duke u përmirësuar , edhe numri ditor i përfaqësimeve në gjykatë të çështjeve konkrete ka rënë. Po kështu, prokurorët dhe oficerët e seksionit të prokurorisë shfrytëzojnë edhe kohën e lirë mbasdite dhe ditët e pushimit për të punuar e përballuar ngarkesën në punë.
- Vonesat në administrimin e akteve të ekspertimit, veçanërisht nga Instituti i Policisë Shkencore, kanë qenë një shkak që kanë zvarritur hetimet në disa çështje penale. Aktet që kanë vonuar më shumë kanë qenë ato teknike-kompjuterike të pajisjeve elektronike, aktet biologjike dhe më pak aktet e tjera.
- Vonesat e krijuara nga lëvizja në sekretaritë e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe të gjykatës të fashikujve të çështjeve të deleguara apo të kthyer, sjellin për pasojë vonesa në trajtimin e rasteve.
- Pothuajse gati 100 % e çështjeve të regjistruara pas prishjes së vendimeve të mosfillimit nga gjykata, asnjëherë nuk kanë shkuar për gjykim, por janë pushuar. Megjithatë, prishja e vendimeve të mosfillimit, ka rritur angazhimin e prokurorit në regjistrimin e materialeve kallëzuese, pasi i paraprin vendimarrjes së mundshme të gjykatës.
- Arsytimi me vonesë i vendimeve nga gjykatat ka sjellë probleme si në fazën e hetimit, ashtu edhe të ekzekutimit të vendimeve penale.
- Sistemi Cams është shumë i ngadaltë dhe krijon vonesa në përpunimin e të dhënave. Në rast se do të evitoheshin vonesat, ky sistem do të ishte shumë i përshtatshëm për përpunimin e të dhënave dhe mbajtjen e statistikës.
- Aksesit në sitemet online jo gjithmonë është i mundur, ku veçohet që Regjistri i Llogarive Bankare nuk është akoma i aksesueshëm, sistemi Tims nuk funksionon gjithmonë dhe ASHK nuk filtron gjithë informacionin.
- Lidhur me hetimet pasurore dhe ato për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, hetimet nuk janë zhvilluar me efektivitet të plotë dhe kryerja e ekspertimeve ekonomike kërkon angazhimin e ekspertëve jashtë territorit të Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër. Kjo ka shkaktuar edhe zvarritje të hetimeve dhe mospasjen e shpejtësisë së duhur në hetimin e këtyre çështjeve.

Të gjitha këto shqetësime që u përmendën, diktojnë marrjen e masave dhe pritshmëritë pas zbatimit të tyre, përbëjnë objektivat tona themelore për vitin 2023 e në vazhdim.

Gjirokastrë më 25.02.2023.

Duke ju falenderuar,

**PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
GJIROKASTËR**